



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 46 (827744)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 12 Nëntor 2021

Ministri i Mbrojtjes viziton Shkollën e Trupës në Bunavi



Niko Peleshi: Ne do ta bëjmë institucionin e Akademisë së FA-së një institucion model

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi vizitoi mjesditet e Shkollës së Trupës në Bunavi, ku bisedoi me studentët e vitit të parë si dhe ndoqi disa orë stërvitore. Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi u tregoi rekrutëve të rinj për ambiciet e qeverisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes për modernizimin e Forcave të Armatosura që së pari

ka nisur nga Akademia e FA-së. Z. Peleshi bëri të ditur se tashmë kanë nisur diskutimet me njërin nga institucionet kampion të edukimit siç është akademia ushtarake e West Point në SHBA, nga i cili do të adoptohen modelet, standardet dhe arrijtet edhe në Akademinë e FA-së. Po ashtu ministri Peleshi... >>> faqe 4

QENDRA KOMBËTARE E KËRKIM - SHPËTIMIT

Mobilizim total për realizimin e planit të veprimit për zbatimin e "Planit Kombëtar të Kërkim - Shpëtimit"



>>> faqe 7

BUXHETI 2022

Kryeministri Rama: Rritja e pagave me 30% për FA do të ndihmojë në një performancë më të mirë

Peleshi për FA: Historike dhe e prekshme një arritje e madhe ky buxhet, që është rritja 30% e pagave nga ushtari i parë te oficerët e gradave të larta >>> faqe 2-3



SHAPE

Gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj: Zona euroatlantike ofron paqe, prosperitet dhe siguri

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, Gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj zhvilloi një vizitë zyrtare dyditore në Komandën Supreme të Aleancës në Evropë (SHAPE), në Mons, Belgjikë. Gjatë kësaj vizite SHSHPFA u prit dhe pati takime me komandantin e Komandës së Operacioneve të NATO-s (ACO) gjeneral Tod D. Wolters, zëvendëskomandantin gjeneral Tim Radford dhe zëvendëshefin e Shtabit...



>>> faqe 6

Koncepti i barazisë gjinore

Femrat në karrierë, miti që theu tabutë

Koncepti i barazisë gjinore është tregues esencial social me të cilin mund të "matet" dhe vlerësohet niveli i emancipimit të shoqërisë shqiptare, qëndrimi i saj ndaj femrës dhe roleve të saj gjinore dhe qytetare. Natyrisht nuk mund të mohohet beteja që ka nisur në fushën e lirive dhe të drejtave të gruas në shoqërinë tonë. Madje tani intensiteti dhe sensibiliteti ka filluar të jetë në nivele më të larta se kurrë ndonjëherë. Por kjo "luftë" për barazi gjinore në shoqërinë tonë zhvillohet...

>>> faqe 9

Stoltenberg në Këshillin Nordik:

Institucionet e forta ndërtojnë besimin dhe paqen

>>> faqe 8



TAKIMI

Sekretari i Përgjithshëm i MM Kamenica, vizitë në Komandën e Forcës Ajrore

faqe 5

VIZITA

Peleshi në Maqedoninë e Veriut, rikonfirmohet qëndrimi se e ardhmja e dy vendeve i përket integritetit euroatlantik

faqe 5

"PROJEKTBUXHETI 2022"

Ministri Peleshi: Me buxhetin e vitit 2022 kemi parashikuar të shkojmë në 1,75%

Ministri i mbrojtjes Niko Peleshi në projektbuxhetin e vitit 2022 parashtron qëllimet e Forcave të Armatosura për të arritur standartet e ushtrive të partnerëve të saj.

Në projektbuxhet parashikohet dhe rritja e pagave nga ushtari i parë te oficerët e gradave të larta deri në 30%.

Sipas ministrit të Mbrojtjes "Buxheti i MM ka një lloj veçantë, sepse ne kemi disa angazhime në NATO. Dhe kështu, sipas angazhimeve që kemi në këto struktura buxheti i MM i raportuar në NATO deri më 2024 duhet të pësojë një rritje graduale, sipas një grafiku të deklaruar, për të arritur në vitin 2024 në 2% të PBB. Sot jemi 1,47-1,48% të GDP. Me buxhetin e vitit 2022 kemi parashikuar të shkojmë në 1,75%; pra ky buxhet është 1,75 e PBB. Në 2023 do të shkojmë në 1,85% të PBB dhe në 2024-ën në 2%, duke përmbytur kështu edhe detyrimet në NATO".

"Detyrimi në NATO në raport në buxhetin nuk ka vetëm një shifër, nuk ka vetëm 2% ka edhe një shifër tjetër, që do të thotë: 20% e këtij buxheti duhet të përdoret për investime. Sa i përket kësaj shifre së dytë, ne e kemi kapur. Që në vitin 2021 përqindja e buxhetit të alokuar për investime është 20,46%. Në 22 shkollon 31,38%. Pastaj 29% pastaj sërish 31,26%. Pra 50% me tepër se sa është kërkesa edhe detyrimi i raportuar në NATO." - theksoi z.Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes u shpreh se janë nëntë drejtime kryesore, ku është fokusuar detajimi i Buxhetit 2022:

1. Mbështetja për personelin;
2. Modernizimi dhe Infrastruktura;
3. Arsimitimi dhe kualifikimi;
4. Gatishmëria dhe mirëmbajtja;



5. Stërvitjet;
 6. Strukturat dhe angazhimet ndërkombëtare;
 7. Mbështetja me mallra e shërbime dhe mbështetja administrative;
 8. Mbrojtja Civile;
 9. Operacionet brenda dhe jashtë vendit.
- Z. Peleshi u shpreh se "projekti më i rëndësishëm në kuadër të infrastrukturës sonë është ndërtimi i Bazës Taktike të Kuçovës, që do të jetë një bazë taktike e NATO-s, investimi kryesor, realizohet nga fondet e NATO, tashmë të prokuruar nga Agjencia e Prokurimit të NATO-s në masën 40 milion euro. Së shpejti nisin punimet. Janë përzgjedhur nga NATO kontraktorët, ne na duhet të bëjmë, pra është detyrimi ynë të bëjmë një pjesë të punimeve, pra diçka më shumë se 10% përballohet nga buxheti ynë. Kemi gati

projektin. Është parashikuar buxheti si e thashë edhe pak më lartë. Jemi në prag të fillimit të punës për ndërtimin e perimetrit të sigurisë. Si dhe punime të tjera si shpronësimet që janë detyrimi i Shqipërisë në këtë projekt."

Një tjetër investim për të cilin është menduar në buxhetin e vitit 2022 është edhe Akademia e FA. "Edukimi ushtarak është tani një prioritet për ne. Keni dëgjuar për Akademinë e FA dhe për përpjekjet për të ndërtuar partneritete të rëndësishme me Akademi të mirënjohura siç është Akademia Ushtarake e West Point-it në SHBA. Kemi zhvilluar një vizitë shumë të suksesshme me kryeministrin e vendit Rama dhe synojmë që të rimodelojmë Akademinë tonë sipas modelit të West Point-it", - tha Peleshi.

Në buxhetin e vitit 2022 janë parashikuar edhe mbi 20 milionë dollarë, ose 2,1 miliardë Lek për Emergjencat Civile, i cili do të ndahet në 1,1 miliardë si transfertë e kushtëzuar për bashkitë, sipas peshës specifike që buxheti i çdo bashkie ka në totalin e buxhetit vendor. Ndërkohë fondi prej 800 milionë lekësh për investimet në fushën e Mbrojtjes dhe parandalimit të emergjencave civile, i cili do të transferohet tek bashkitë për projekte, që do të seleksionohen nga një komitet që do të ngrihet dhe do të bëjë përzgjedhjen e propozimeve nga njësitë vendore.

Ministri i Mbrojtjes konfirmoi se pjesëmarrjen e misioneve të FA në kuadër të operacioneve të NATO-s, duke rritur nivelin e angazhimit të FA, në operacionet e Aleancës në Kosovë apo në operacionet e BE-së në Bosnjë-Hercegovinë dhe Mali, OKB-së në Sudanin Jugor si dhe pjesëmarrjen në misionet e iniciativat e reja që NATO mund të ndërmarrë në Irak.

"Buxheti është rritur me 32.6 mld lekë më shumë"**Peleshi për FA: Historike dhe e prekshme një arritje e madhe ky buxhet, që është rritja 30% e pagave nga ushtari i parë te oficerët e gradave të larta**

Objektivi është që në vitin 2024 të vendoset në dispozicion 2% e GDP. "Defender 23" do ketë vend pritës Shqipërinë!

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, gjatë prezantimit të buxhetit të viti 2022, tha se ky vit parashikon rritje për Forcat e Armatosura, rreth 32.6 mld lekë më shumë se ai i një viti më parë.

Ai tha se objektivi i kësaj ministrie, kërkuar dhe nga NATO, është që në vitin 2024 buxheti të jetë 2% i prodhimit të brendshëm bruto.

Po ashtu, Peleshi tregoi se stërvitja e përbashkët e NATO-s "Defender 2023", do të ketë vend pritës Shqipërinë, si dhe shtoi se qeveria ka parashikuar të rrisë buxhetin, e thënë në kuota buxheti i mbrojtjes është 32.6 mld lekë. Edhe më e madhe është rritja në zërin e investimeve, 102%.

"Siç u tha dhe siç e dimë ne kemi angazhime buxhetore në aleancën tonë në NATO. Në vitin 2024 të gjitha buxhetet duhet të kapin shifrën e 2% të prodhimit të brendshëm bruto. Ne kemi depozituar në NATO një grafik mbi këtë ecuri. Siç e shikoni, me 1.75% të GDP, ne i përmbahemi angazhimit që të jemi një vend dinjitoz në NATO. E cilësoj historike e të prekshme një arritje të madhe këtë buxhet, që është rritja e pagave nga ushtari i parë te oficerët e gradave të larta. Duke pasur më shumë se 6 mijë përfitues. Është e freskët dita ku ne vlerësuam të gjithë pjesëmarrjen e efektiveve tanë, në emergjencën e jashtëzakonshme të zjarreve të gushtit. Aty kryeministri ka bërë të njohur rritjen e pagave të ushtarakëve. Ne kemi arritur në



rritjen 30% të pagës, as unë nuk e prisja. Kështu që zoti kryeministër në emër të FA-së faleminderit.

Ne ju sigurojmë që do të ketë më shumë motivim në rekrutimet tona. Me këtë pagë dinjitoze, FA do të bëhet më e angazhuar për të rinjtë. Zyrat tona të rekrutimeve nuk janë në lartësinë e duhur. 65% është rritja për modernizim. Do të investojmë edhe në pikat tona të dobëta. Në të ardhmen me këto hapësira buxhetore duhet të ndreqim disa fusha ku kemi punë për të bërë, këtu e kam fjalën për gatishmërinë e forcave ajrore, fushore, duhet të gjejmë recetën e duhur për të pasur gatishmëri më të lartë, e për këtë kemi aplikuar së pari një bashkëpunim me një agjenci të NATO-s për mirëmbajtjen e helikopterëve. Duam ta shtrijmë këtë praktikë që na rezultojnë të suksesshme në të gjitha forcat tona. Duhet të aplikojmë "smart defense" duke koordinuar burimet dhe blerjet me vendet mike,

si Kosova, që është një vend i afërt me ne, jemi vëllezër e s'kemi çfarë t'i fshehim njëri-tjetrit. Unë kam bërë disa takime me homologët në rajon për të parë mundësinë e aplikimit të "smart defense". Me shumë gjasa edhe "Defender 23" do të ketë si vend pritës Shqipërinë. Kemi dalë me rekorde pozitive nga "Defender 21". Mbrojtja civile është ajo që na bën më të dukshëm, na sjell më pranë komunitetit. Jetojmë në një rajon të ekspozuar nga risqet ajrore. Ndaj na duhet të jemi më të shkathët dhe koordinues. Ky buxhet e reflekton këtë ambicie. 1.1 mld do të jetë transfertë e pa kushtëzuar për bashkitë. 800 mln të tjera do të jenë në dispozicion për bashkitë. Viti 2022 do të jetë viti ku do të jetësohet një projekt i konsiderueshëm i mbështetur nga Italia në fushën e emergjencës civile, ku do të përfitojnë edhe bashkitë që do të pajisen me mjete dhe burime financiare", -tha Peleshi.



Kryeministri Edi Rama, në një takim me Forcat e Armatosura që kishte si qëllim diskutimin mbi buxhetin 2022 për Ministrinë e Mbrojtjes, tha se sot ushtria jonë nuk është më e fundit në NATO për nga pagat që marrin efektivet.

Rama tha se rritja e pagave me 30 për qind për Forcat e Armatosura do të ndihmojë në një performancë më të mirë, ndërsa tha se në 2022 do të nisë një megaprojekt për të kthyer ushtrinë në një model edhe për vende të tjera.

“Së pari dua t’ju them, meqë me jepet kjo mundësi, që jam ndjerë shumë mirë dhe krenar duke dëgjuar fjalë nga më mbresëlënëset prej gjeneralëve që ishin këtu dhe drejtuan misionin e madh, stërvitjen “Defender Europe 2021”, dhe realisht ju nuk i keni dëgjuar në media se nuk kanë qenë për to, ishin fjalë admirimi për të gjithë ju dhe të tjerë të FA-së. Aktiviteti juaj zhvillohet jashtë syve të publikut, dhe duhet të kesh lidhje që ta kuptosh rëndësinë e sakrificave dhe vlerës që keni për atdheun.

Nga ana tjetër dua që sinjerisht t’i përshëndes familjet tuaja, sepse nuk ka asnjë punë të lehtë kur puna duhet bërë mirë, por puna juaj ka brenda dhe imponimin e një sakrifice shumë të madhe”, -tha Rama

“Më vjen mirë t’ju them se unë e shoh me optimizëm çdo ditë të nesërme të FA-së, sepse jo vetëm që do i krijojmë deri në fund mundësitë për të fituar nga koha e humbur por dhe për të zvogëluar hendekun me trupa të tjera të aleancës në aspektin e financave, kushteve dhe bonuseve që rrjedhin nga kontributi juaj.

Ne në aspektin e FA-së, me këtë rritje pagash, nuk kemi më ushtrinë më të pak paguar në NATO si fillim, nuk jemi as në krye as në mes dhe as nuk jemi më të fundit dhe ambicia është që brenda mandatit të tretë të jemi diku në mes, besoj bashkë do e arrijmë para, atë që do të marrim mbrapa nga ky investim.

Ju e keni nderuar Shqipërinë dhe e keni vendosur qeverinë në pozitë që pavarësisht vështirësive që kemi, që lidhen qoftë me tërmetin apo edhe me krizën energjetike, kështu që e meritoni, se pavarësisht se ushtria në numër është modeste, ta rrisim në cilësi, që ushtria të jetë model. Tjetra ka të bëjë me bazën, hyrjen në rrugën ushtarake, dera e akademisë, dhe nuk mund të pretendojmë të jemi të mirë kur nuk kemi një bazë në lartësinë e asaj që meritojnë ata që regjistrohen

BUXHETI 2022

Rama: Rritja e pagave me 30 për qind për Forcat e Armatosura do të ndihmojë në një performancë më të mirë

Viti 2022 do të jetë fillimi i një megaprojekti për të kthyer ushtrinë në një model edhe për vende të tjera



aty, është inekzistente me atë që duhet të jetë për një ushtri në nivelin e NATO-s”, -u shpreh Kryeministri.

Do fillojmë në 2022 një mega-

projekt me faza, e para do garantojë gjithçka sot duhet të ofrojmë, dhe pastaj dy faza që do të garantojnë ato që ne duam të plotësojmë. Do të

ndërtojmë një akademi model cilësie. Pika tjetër është domosdoshmëria për të krijuar paralelisht me gjithë kapacitetin e gatishmërisë në terren

Jam ndjerë shumë mirë dhe krenar duke dëgjuar fjalë nga më mbresëlënëset prej gjeneralëve që ishin këtu dhe drejtuan misionin e madh, stërvitjen “Defender Europe 2021”, dhe realisht ju nuk i keni dëgjuar në media se nuk kanë qenë për to, ishin fjalë admirimi për të gjithë ju dhe të tjerë të FA-së. Aktiviteti juaj zhvillohet jashtë syve të publikut, dhe duhet të kesh lidhje që ta kuptosh rëndësinë e sakrificave dhe vlerës që keni për atdheun.

me trupa dhe armë konvencionale”, -shtoi Rama.

Sipas kreut të qeverisë, zhvillimet teknologjike nga Forcat e Armatosura do t’i shërbejnë edhe qytetarëve dhe vendit. Dhe për ta bërë këtë, Rama bëri me dije se ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi ka biseduar për të rekrutuar nëpër botë shqiptarët që punojnë si programues.

“Mundësia, potenciali dhe ambicia që ushtria jonë, gjithë sistemi i Ministrisë së Mbrojtjes, trupave tokësore të kenë në dispozicion një hapësirë ku të bëhet kërkim shkencor, duke iu dhënë mundësi vajzave dhe djemve në këto forca që të kenë mbështetje për të zhvilluar së brendshmi kapacitetet teknologjike të ushtrisë shqiptare. Dihet botërisht që sistemet e mbrojtjes janë sisteme ku janë bërë çudira nga pikëpamja teknologjike, që i kanë shërbyer pastaj gjithë vendit edhe gjithë botës. Ne pretendojmë që sistemi ynë i mbrojtjes t’i shërbejë vendit. Kemi folur me ministrin që Forcat e Armatosura të krijojnë një mekanizëm rekrutimi të këtyre talenteve shqiptare nëpër botë që punojnë si programues, kërkues shkencor në fushën e teknologjisë, për t’u vënë në dispozicion të kësaj hapësire të re në sistemin tonë të mbrojtjes”, -u shpreh ndër të tjera Kryeministri Edi Rama.



Ministri i Mbrojtjes viziton Shkollën e Trupës në Bunavi

Niko Peleshi: Ne do ta bëjmë institucionin e Akademisë së FA-së një institucion model edhe për institucionet e tjera të edukimit të lartë

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi vizitoi mjediset e Shkollës së Trupës në Bunavi, ku bisedoi me studentët e vitit të parë si dhe ndoqi disa orë stërvitore.

Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi u tregoi rekrutëve të rinj për ambiciet e qeverisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes për modernizimin e Forcave të Armatosura që së pari ka nisur nga Akademia e FA-së.

Z. Peleshi bëri të ditur se tashmë kanë nisur diskutimet me njërin nga institucionet kampion të edukimit siç është akademia ushtarake e West Point në SHBA, nga i cili do të adoptohen modelet, standardet dhe arrijtet edhe në Akademinë e FA-së.

Po ashtu ministri Peleshi tregoi edhe projektet që janë në funksion të kësaj akademie. “Një kampus i ri nga fillimi, në një sipërfaqe të dedikuar për të do të fillojë ndërtimin nga viti që vjen. Jemi gati me projektet, jemi gati me planin, jemi gati me buxhetet edhe projekt-buxheti i këtij viti na e ka dhënë të gjithë hapësirën për të ndërtuar nga e para, me një standard shumë të lartë evropian kampusin, klasat, hotelerinë dhe gjithë infrastrukturën tjetër në mbështetje të aktivitetit tuaj. Ne do ta bëjmë institucionin e Akademisë së FA-së një institucion model edhe për institucionet e tjera të edukimit të lartë, ndaj po hapim dhe dimensione të tjera përveç atij tradicionalit”, - u shpreh z. Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes vuri në dukje vlerësimet që Forcat e Armatosura shqiptare kanë marrë nga vendet partnere të NATO-s, ndaj edhe Shqipëria mund të bëhet sërish vendi mikpritës i stërvitjes më të madhe “Defender” në vitin 2023.

“Jemi anëtarë të denjë në NATO, kemi përfaqësuar vendin tonë, një vend të vogël me burime të kufizuara, por me shpirt të madh në misionet ndërkombëtare duke fituar një emër të mirë në radhët e NATO-s. Unë dëgjoj vetëm fjalë të mira në takimet, në samitet e NATO-s, ministrialet e NATO-s, ministrialet rajonale për përfaqësimin e vajzave dhe djemve shqiptarë në botë, në misionet ndërkombëtare. Këtë vit patëm shansin të integrohemi në një shkallë më të gjerë, në stërvitjen më të madhe të zhvilluar në 30 vite në rajonin tonë

“Defender ‘21”. Pas dy vitesh me shumë mundësi “Defender ‘23” do të ketë si vend pritës Shqipërinë. Kjo është një mundësi e jashtëzakonshme e juaja për t’u ballafaquar me forca të tjera të ushtrive të tjera, për t’u integruar me ta, për të rritur ndërveprueshmërinë edhe për të fituar mbi të gjitha besim se dhe një vend i vogël si Shqipëria mund të luajë një rol të madh”, - u shpreh ministri Peleshi. Duke u uruar mirëseardhjen në FA rekrutëve të rinj, ministri Peleshi tha se edhe procesi i rekrutimit do të ngrihet në një nivel tjetër, në mënyrë që të përthithen sa më shumë djem e vajza nga rinia shqiptare.



QAPN mirëpret ekipin ushtarak të Gardës Kombëtare të New Jersey-it

Në kuadër të bashkëpunimit me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, u zhvillua një takim pune në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve me një ekip ushtarakësh i përbërë nga Nënkolonel Dave Melendez dhe Rreshter Rodriguez.

Objekti i këtij takimi ishte njohja me misionin e QAPN (programet, kurrikulat) dhe kurset që zhvillohen pranë kësaj qendre.

Gjatë takimit me ekipin amerikan, u brifua në detaje rreth funksionimit të QAPN-së, fushat e bashkëpunimit që kemi pasur me NJNG, ku u theksua që ky bashkëpunim do të vijojë edhe në të ardhmen, kryesisht në sferën e arsimit dhe trajnimit.



MISIONIN DHE DETYRAT QË REALIZON KJO STRUKTURË E RËNDËSISHME E FORCAVE TË ARMATOSURA

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes vizitë në Komandën e Forcës Ajrore



Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, z. Adrian Kamenica është pritur në takim nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj, në ambientet e Garnizonit Rinas.

Në këtë takim, kolonel Pulaj pas urimit të mirëseardhjes, dhe prezantimit të stafit të komandës dhe shtabit të Forcës Ajrore ka njohur Sekretarin e Përgjithshëm me misionin dhe detyrat që realizon kjo strukturë e rëndësishme e Forcave të Armatosura si dhe me zhvillimet e sfidat e së ardhmes të Forcës Ajrore. Fokusi kryesor i takimit ishte njohja me procedurat e mirëmbajtjes së mjeteve ajrore.

Sekretari i Përgjithshëm, z. Kamenica shprehu gatishmërinë për të mbështetur strukturat e Forcës Ajrore me synim arritjen e objektivave dhe misionit.

Në fund të prezantimit, pati një seancë diskutimesh, çështje për të cilat u synua për gjetjen e zgjidhjeve sa më efikase dhe efektive.



VIZITA

Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut si vende aleate të NATO-s rikonfirmojnë mbështetjen reciproke dhe ndajnë qëndrimin e përbashkët se e ardhmja e rajonit i përket integritetit euroatlantik.

Ky qëndrim u theksua nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi gjatë vizitës së tij në Shkup, ku u takua me presidentin e Maqedonisë së Veriut Stevo Pendarovski, kryetarin e Kuvendit Talat Xhaferri, ministrin e Punëve të Jashtme Bujar Osmani si dhe homologen e tij Radmila Shekerinska.

Gjatë takimit me ministren e Mbrojtjes Radmila Shekerinska u nënvizua rëndësia e intensifikimit të aktiviteteve të përbashkëta, por edhe mundësia për rishikimin e përshtatjen e kuadrit ligjor të këtij bashkëpunimi me aktualitetin. Dy ministrat ndanë të njëjtin qëndrim për të rritur bashkëpunimin dypalësh, sidomos në fushën e arsimit, edukimit dhe stërvitjes, mbrojtjes civile, por dhe zhvillimeve në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, ku u përmend dhe konkretisht një qasje rajonale për projektin DIANA në kuadër të NATO-s.

Një fokus të veçantë gjatë takimit mori dhe ndërveprimi në iniciativat rajonale, US-A5, SEDM, etj., por edhe në Qendrën Rajonale për Marrëdhëniet me publikun. Ministrat Peleshi e Shekerinska theksuan mbështetjen për politikën e dyerve të hapura në rajon. Nga ana e tij, ministri shqiptar falënderoi homologen e Maqedonisë së Veriut për qasjen pozitive dhe aktive ndaj Kosovës.

Në takimet e tjera me drejtuesit kryesorë të politikës në Maqedoninë e Veriut u fol gjerësisht për situatën aktuale politike atje, perspektivën euroatlantike të dy vendeve si dhe zhvillimet aktuale në mjedisin e sigurisë dhe mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor. Ministri Peleshi falënderoi z. Xhaferri dhe z. Osmani për qasjen konstruktive ndaj çështjeve që prekin shqiptarët në Maqedoninë e Veriut dhe për rolin që ata dhe i gjithë faktori shqiptar kanë për të ardhmen e shtetit dhe prosperitetin e gjithë qytetarëve të Maqedonisë së Veriut.

Ministri Peleshi në Maqedoninë e Veriut, rikonfirmohet qëndrimi se e ardhmja e dy vendeve i përket integritetit euroatlantik

Ministrat Peleshi dhe Shekerinska theksuan mbështetjen për politikën e dyerve të hapura në rajon



Bashkëpunimi ndërmjet Forcës Detare italiane dhe shqiptare për "AL-8 Expert's Meeting in the Field of MSA (V-RMTC)"

Në kuadër të aktivitetit të Planit të Bashkëpunimit Ushtarak dypalësh me Forcën Detare të Italisë, "AL-8 Expert's Meeting in the Field of MSA (V-RMTC)", në Forcën Detare zhvilluan vizitë ekspertë të Forcës Detare Italiane.

Në Komandën e Qendrës së Vëzhgimit Detar të Forcës Detare, u zhvillua një takim pune. Pasi Komandanti i Qendrës së Vëzhgimit Detar, N/Kolonel Besnik Borici, u uroi mirëseardhjen përfaqësuesve italianë si dhe vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm, u diskutua mbi rëndësinë e bashkëpunimit dypalësh, shkëmbimi i të dhënave të V-RMTC-, azhurnimet e aplikacioneve të reja që do të përdoren për V-RMTE, mundësitë teknike për përmirësimin e rrjetit VRMT, ndërveprimet e mundshme, rëndësinë e zhvillimit të stërvitjes si dhe trajnimi i personelit të Forcës Detare për V-RMTC, shkëmbimi i të dhënave të V-RMTC.

Në komandën e Forcës Detare, ekipi Italian i ekspertëve u prit nga Shefi i Shtabit të Forcës Detare, kapiten i rangut të I-rë Engjëll Sinanaj, i cili i uroi mirëseardhjen dhe shprehu vlerësimin për bashkëpunimin e deritanishëm midis Forcës Detare Italiane dhe Forcës Detare shqiptare.



AFA pjesë e trajnimeve të programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin në Shqipëri (UNDP)

Politikat dhe Procedurat kundër dhunës e ngacmimit në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, Parimet dhe Standardet e një mjedisi të sigurt pune

Në kuadër të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin në Shqipëri (UNDP), në ambientet e "Hotel Rogner" në bashkëpunim me përfaqësues nga UNDP Shqipëri dhe me përfaqësues nga personeli ushtarak dhe civil i AFA-së, u organizua trajnimi "Politikat dhe Procedurat kundër dhunës e ngacmimit në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, Parimet dhe Standardet e një mjedisi të sigurt pune". Ky trajnim i nivelit të dytë me stafin akademik të AFA-së, synoi kryesisht njohjen e personelit ushtarak dhe civil në institucionet e FA-së, me rregulloren e disiplinës dhe

implementimin e Dokumentit të Politikës dhe Procedurave kundër dhunës dhe ngacmimit, miratuar nga Ministri i Mbrojtjes në muajin mars të vitit të kaluar.

Aktiviteti i organizuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Akademia e Forcave të Armatosura, me mbështetjen e UNDP Shqipëri, erdhi në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "T'i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri", financuar nga qeveria e Suedisë, zbatuar nga UNDP, UN Women dhe UNFPA. Në këtë trajnim morën pjesë përfaqësues nga të gjithë sektorët e AFA-së.



Komanda Supreme e Aleancës në Evropë (SHAPE),

Gjeneralmajor prof. asoc. Begaj: Zona euroatlantike ofron paqe, prosperitet dhe siguri

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj zhvilloi një vizitë zyrtare dyditore në Komandën Supreme të Aleancës në Evropë (SHAPE), në Mons, Belgjikë.

Gjatë kësaj vizite SHSHPFA u prit dhe pati takime me komandantin e Komandës së Operacioneve të NATO-s (ACO) gjeneral Tod D. Wolters, zëvendëskomandantin gjeneral Tim Radford dhe zëvendësshefin e Shtabit të kësaj komande gjenerallejtnant Brice Houdet.

Gjeneralmajor Begaj, gjatë takimit të zhvilluar me gjeneral Wolters, pasi vlerësoi kontributin e ACO, si një komandë strategjike për planifikimin, monitorimin dhe zhvillimin e operacioneve të NATO-s, vuri theksin dhe vlerësoi rolin drejtues të gjeneral Wolters dhe burrave dhe grave nën uniformë që shërbejnë në këtë komandë. "Zona euroatlantike ofron paqe, prosperitet dhe siguri për shkak të punës, angazhimit, bashkëpunimit dhe koordinimit të ACO, strukturës komanduese të saj, si dhe lidershit dhe gjithë personelit ushtarak të cilët janë në gatishmëri, patrollojnë ujërat dhe hapësirën ajrore, stërviten dhe trajnohen për sigurinë e qytetarëve tanë. Megjithatë, liria nuk është e lirë, ndaj përulemi përpara atyre që kanë dhënë jetën në krye të detyrës në misionet e NATO-s", - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Begaj.

Nga ana e tij, gjeneral Wolters vlerësoi rolin dhe angazhimin e Shqipërisë në misionet dhe aktivitetet e NATO-s që nga Afganistani në Kosovë, detin Egje, në Letoni si dhe kontributin në strukturat komanduese të NATO-s. Ai gjithashtu vlerësoi rolin kyç të Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor duke kontribuar në sigurinë e përbashkët. "Shqipëria ka demonstruar një angazhim të hekurit për të përmirësuar sigurinë dhe stabilitetin në Ballkan dhe Mesdhe që prej anëtarësimit të saj në NATO. Mezi presim të punojmë me Forcat e Armatosura shqiptare në stërvitjen "Defender 2022" për të përmirësuar operacionalitetin dhe gatishmërinë e forcave ushtarake të Aleancës për ruajtjen e paqes në zonën euroatlantike", - theksoi gjeneral Wolters gjatë takimit.

Më tej dy ushtarakët e lartë shkëmbyen vlerësimet e tyre për situatën e

"Liria nuk është e lirë, ndaj përulemi përpara atyre që kanë dhënë jetën në krye të detyrës në misionet e NATO-s"



sigurisë në rajonin e Ballkanit e më gjerë. Në veçanti, u vlerësua misioni i KFOR-it si një nga operacionet më të suksesshme të NATO-s në këto dy dekada dhe roli i tij në situatën e sigurisë dhe paqes në rajon.

Gjeneralmajor Begaj, zhvilloi gjithashtu një takim me zëvendëskomandantin e ACO, gjeneral Radford, ku u diskutua rreth zbatimit të konceptit të NATO-s për mbrojtjen e zonës euroatlantike (Deterrence and Defence of the Euro-Atlantic Area Of Responsibility) dhe gjenerimit të forcës për operacionet dhe aktivitetet e Aleancës.

Gjeneralmajor Begaj vlerësoi në veçanti rolin e gjeneral Radford për ta çuar më tej këtë koncept dhe kontributin që ai do të ketë për sigurinë e zonës së përgjegjësisë së NATO-s. Ndërsa Gjeneral Radford, falënderoi SHSHP të FA-së për kontributin dhe vlerësimet e situatës së sigurisë në rajonin e Ballkanit të cilat ndihmojnë në pasjen e një pamjeje të qartë për t'u marrë në konsideratë gjatë procesit të planifikimit operacional për këtë rajon.

Në mbyllje të vizitës së tij zyrtare në SHAPE, gjeneralmajor Begaj, zhvilloi një takim edhe me përfaqësuesin ushtarak kombëtar, kolonel Petrit Çuni si dhe personelin e FARSH që shërben në këtë komandë.

Komanda e Operacioneve të Aleancës, u krijua dy vjet pas themelimit të



NATO-s, në vitin 1951 si komanda e parë në nivelin strategjik. Komandanti i parë ishte gjenerali Dwight D. Eisenhower, i cili kishte titullin Komandant Suprem i Aleatëve në Evropë (SACEUR). Shtabi Suprem i Fuqive Aleate në Evropë ndodhej në periferi të Parisit të Rocquencourt, Francë.

Në vitin 1967 SHAPE u zhvendos nga Rocquencourt, Francë, në Casteau, Belgjikë, si rezultat i vendimit të presidentit francez Charles de Gaulle për të tërhequr vendin e tij nga struktura e integruar e komandës ushtarake e NATO-s.

Në Samitin e Pragës në vitin 2002, vendet anëtare të NATO-s ranë dakord për një riorganizim të madh të strukturës komanduese të NATO-s, sipas të cilit do të kishte vetëm një komandë të nivelit strategjik përgjegjës për të gjitha operacionet e NATO-s, me titullin e Komandës Aleate të Operacioneve. Për arsye historike dhe financiare/juridike, selia e ACO ruajti titullin e saj tradicional SHAPE dhe komandanti i saj emërtimin tradicional si SACEUR.

Vizioni i ACO do të jetë një komandë me cilësi të lartë përgjegjëse për planifikimin dhe ekzekutimin e operacioneve të kombinuara, të përbashkëta, të bazuara në efekte. Misioni: Të përgatitet, të planifikojë dhe të kryejë operacione ushtarake për të përmbushur objektivat politike të Aleancës.



Qendra Kombëtare e Kërkim - Shpëtimit

Mobilizim total për realizimin e planit të veprimit për zbatimin e "Planit Kombëtar të Kërkim - Shpëtimit"

NGA NËNKOLONEL VASIL TACI

Shërbimi i kërkim-shpëtimit (Search and Rescue-SAR), është një detyrim ndërkombëtar me mision të qartë dhe raport korrekt me sovranitetin kombëtar. I organizuar me sistem gatisshmërie dhe reagimi 24/7 ai aktivizohet gjatë aksidenteve ajrore dhe detare kur jeta e njerëzve është në rrezik, duke përfunduar operacionin kur jetët njerëzore janë shpëtuar apo rastin më të keq kur nuk ka më shpresë për të mbijetuarit. Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit është një strukturë kombëtare në vartësi të ministrit të Mbrojtjes me një përgjegjësi të madhe shtetërore.

Një nga detyrat prioritare të QKKSH për vitin 2021 ka qenë dhe është ndjekja dhe zbatimi i detyrimeve të Planit Kombëtar të Kërkim -Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë, miratuar me VKM nr. 729, datë 13.11.2019 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Kërkim Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe Planit të Veprimit të tij". Miratimi i Planit Kombëtar të Kërkim Shpëtimit nga qeveria, ishte një arritje e rëndësishme në konsolidimin dhe mirëfungsionimin e shërbimit të kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë, pasi në të përcaktohen saktësisht përgjegjësitë dhe detyrimet e strukturave shtetërore përgjegjëse për kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë, për të vepruar në rastet e emergjencave SAR.

Plani i veprimit për zbatimin e Planit Kombëtar të Kërkim Shpëtimit përmban 9 (nëntë) rubrika me rreth 70 (shtatëdhjetë) masa të shtrira për realizim në një periudhë kohore gjashtëvjeçare (2019-2025) për shërbimin SAR në RSH si: Organizimi i shërbimit, nënshkrimi dhe ratifikimi i marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare, rishikimi dhe hartimi i procedurave operacionale, ngritja e infrastrukturës, sigurimi i burimeve njerëzore dhe trajnimi i tyre, modernizimi i pajisjeve, stërvitja e strukturave, monitorimi i zbatimit të planit kombëtar e raportimi si dhe detyra të tjera.

Detyrat janë të shumta por për këtë vit QKKSH u përqendrua në:

Rishikimi i legjislacionit

Plani i Veprimit për Zbatimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit parashikon rishikimin e ligjit nr.10435, datë 23.06.2011 për "Shërbimin e Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve të tjera nënligjore për shërbimin SAR.

Ligji nr.10435, datë 23.6.2011 "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë" është miratuar përpara 10 vitesh me qëllim përcaktimin e rregullave të organizimit të shërbimit të kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë, fushat e zbatimit të këtyre rregullave, institucionet përgjegjëse dhe detyrimet e tyre në fushën e kërkim shpëtimit.

Ky ligj është i domosdoshëm të rishikohet, pasi nga viti 2011 e deri më sot kanë ndodhur shumë ndryshime si në konceptin global e kombëtar të shërbimit të kërkim shpëtimit, ashtu edhe në zhvillimin e teknologjisë e pajisjeve, të cilat gjejnë pasqyrim në ligj.

Ligji nr.10435, datë 23.6.2011 "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë" le vend për mjaft

diskutime dhe interpretime në zbatimin e tij duke sjellë perceptime se shërbimi i kërkim shpëtimit është i njëjti shërbim si emergjencat civile. Ndryshimet dhe shtesat do përcaktojnë qartë se kur flasim për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë, kemi të bëjmë me zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare në fushën e kërkim shpëtimit në rastet e aksidenteve ajrore dhe detare.

Për këtë qëllim me urdhër të ministrit të Mbrojtjes është ngritur dhe po punon një grup pune me specialistë nga QKKSH, Drejtoria e Programimit Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, Shtabi i Përgjithshëm i FA, komandat e forcave dhe atyre mbështetëse, ekspertë nga AKMC, QBO, QNOD dhe drejtoria e Buxhetit në MM.

Nëpërmjet ndryshimeve synohet një përcaktim i qartë për organizimin, strukturat, përgjegjësitë dhe detyrat kryesore të shërbimit të kërkim-shpëtimit si dhe zgjidhja e problemeve të komandim kontrollit dhe mbështetjes financiare të tij.

Hartimi e manualit Kombëtar të Kërkim Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë

Hartimi i një manuali kombëtar gjithëpërfshirës për shërbimin e kërkim-shpëtimit, që është dhe një detyrim i ministrisë së Mbrojtjes nga Plani Kombëtar i Kërkim Shpëtimit u vlerësua si prioritet për këtë vit për t'u përgjigjur situatës aktuale dhe nevojave në fushën e kërkim-shpëtimit. Për këtë qëllim me urdhër të ministrit të Mbrojtjes u ngrit grupi i punës për hartimin e Manualit të Kërkim Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë, i cili pas një pune 6-mujore ka përgatitur draft manualin me rreth 700 faqe. Ky draft është dërguar në Akademinë e Forcave të Armatosura (Institutin Kërkimor Shkencor Ushta-



rak) për korrektrim redaktim dhe faqesje dhe së shpejti do vijojnë procedurat e miratimit e publikimit të tij.

Manuali i Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë është në përputhje të plotë me kërkesat e International Civil Aviation Organization (ICAO) dhe International Maritime Organization (IMO), duke marrë si model manualet e International Aeronautical and Maritime Search and Rescue (IAMSAR). Grupi i punës bashkëpunoi dhe kërkoi asistencë nga specialistë të fushave të ndryshme, Forcat e Armatosura, Mbrojtjes ndaj Zjarrit, Urgjencës Mjekësore, Policisë së Shtetit dhe Policisë së Kufirit dhe Migracionit etj. Gjithashtu kërkoi asistencë nga specialistë të JRCC-ve të vendeve fqinje, specialistë të ICAO dhe IMO, për sigurimin e literaturës së nevojshme, dhe asistencë teknike.

Hartimi i moduleve të trajnimit SAR

Trajnimi personelit/njësive të institucioneve shtetërore të deklaruara për kërkim-shpëtimit (SAR) është një nga

detyrat kryesore të Planit të Veprimit për zbatimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit dhe njëkohësisht prioritet i QKKSH. Me qëllim rritjen e nivelit profesional të kapaciteteve të deklaruara për kërkim-shpëtimit, Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit ngriti një grup pune për të bërë rishikimin dhe hartimin e programeve/moduleve të unifikuara të trajnimit dhe kualifikimit të personelit/njësive të deklaruara për kërkim-shpëtimit (SAR). Edhe këto module do të jenë në përputhje me kërkesat e manualetve IAMSAR (ICAO/IMO) dhe direktivave të dhëna për këtë qëllim.

Bashkëpunimi ndërinstitucional

Bashkëpunimi dhe koordinimi me strukturat ushtarake dhe ministritë e linjës, entet shtetërore dhe ato private, të cilat disponojnë kapacitete SAR, me qëllim njohjen e përgjegjësisë dhe të detyrimeve nga ana e tyre, si dhe marrja e masave për përmirësimin e bashkëpunimit për përdorimin e strukturave operacionale të përbashkëta në përgjigje të situatave dhe zhvillimin e operacioneve SAR ka qenë një prioritet tjetër i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit për vitin 2021.

Qendra kombëtare e Kërkim-Shpëtimit ka pasur dhe ka një bashkëpunim të ngushtë në fushën e kërkim shpëtimit me Forcën Ajrore, Forcën Detare/Rojën Bregdetare, Forcën Tokësore, Komandën Mbështetëse, QNOD, Autoritetin e Aviacionit Civil, Drejtorinë e Përgjithshme Detare, Policinë e Shtetit, Policinë Kufitare dhe Emigracionit, pushtetin lokal, si dhe me Qendrat Rajonale të Koordinim-Shpëtimit (JRCC/ARCC/MRCC) të vendeve fqinje.

Në zbatim të Planit të Koordinimit dhe Bashkëpunimit të QKKSH me strukturat e FA, institucionet shtetërore, pushtetin vendor dhe entet private për kërkim-shpëtimit të miratuar nga ministri i Mbrojtjes, QKKSH ka zhvilluar disa aktiv-

itete koordinimi dhe bashkëpunimi në fushën e kërkim-shpëtimit me Forcën Tokësore, Forcën Detare, Forcën Ajrore, QNOD, Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe Policinë Kufitare e të Migracionit në Durrës, Albcontrol, Aeroportin e Rinastit dhe Aeroportin e Kukësit.

Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte bashkëpunimi dhe koordinimi me strukturat ushtarake, entet shtetërore dhe ato private, të cilat disponojnë kapacitete SAR, njohja e përgjegjësisë dhe detyrimeve nga ana e tyre, si dhe marrja e masave për përmirësimin e bashkëpunimit për përdorimin e strukturave operacionale të përbashkëta në përgjigje të situatave dhe zhvillimin e operacioneve SAR.

Takimi i fundit ka qenë në aeroportin e Kukësit pas hapjes së tij këtë vit, me fokus kryesor njohjen e përgjegjësisë dhe të detyrimeve të ndërsjella, si dhe marrjen e masave për përdorimin e strukturave operacionale të përbashkëta në përgjigje të situatave dhe zhvillimin e operacioneve SAR në zonën e aeroportit.

Bashkëpunimi me vendet fqinje në fushën e kërkim shpëtimit

Detyrimet e QKKSH janë në kuadrin e sistemit global të kërkim-shpëtimit dhe kurrësi nuk mund të kryhen të izoluar. QKKSH ka sot një bashkëpunim të shkëlqyer me Qendrën e Kontrollit të Misionit Satelitor në Bari, Itali (ITMCC) për marrjen, transmetimin dhe procedimin e sinjalit të "alarmit", duke realizuar me sukses të gjitha radio-komunikimet dhe shkëmbimet e informacionit me këtë qendër.

Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit, duke u bazuar në aktet ligjore, konventat ndërkombëtare dhe kërkesat e manualit IAMSAR ka në proces tre draft marrëveshje për kërkim-shpëtimit, me Republikën e Greqisë, me Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe me Republikën e Kosovës, drafte të cilat po ndjekin procedurat e nënshkrimit dhe do jetë dhe si bazë edhe për marrëveshjet e tjera me vendet fqinje si, Malin e Zi, Kroacinë etj.

Monitorimi i kapaciteteve SAR

Muajt e fund-vitit QKKSH do të kryejë monitorimin e zbatimit të Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit, kjo si detyrë e Planit Kombëtar SAR me qëllim evidentimin e kapaciteteve të deklaruara nga institucionet shtetërore dhe jo-shtetërore. Kjo do të shërbejë për të bërë të mundur bashkërendimin e aseteve në operacione reale SAR.



Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s në Këshillin Nordik:

Institucionet e forta
ndërtojnë besimin dhe paqenPËRGATITI:
MSC. MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg vlerësoi Danimarkën për kontributin e saj të fuqishëm në NATO gjatë vizitës së tij në Kopenhagë. Në takim me kryeministren Mette Frederiksen, Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Danimarkën për udhëheqjen e misionit të NATO-s në Irak dhe pjesëmarrjen në praninë e zgjeruar përpara të NATO-s në pjesën lindore të Aleancës. Ata diskutuan përgatitjet për Samitin e NATO-s në Madrid vitin e ardhshëm dhe agjendën e NATO-s 2030. Sekretari i Përgjithshëm pati bisedime me ministrin e Jashtëm Jeppe Kofod, ministrin e Mbrojtjes Trine Bramsen dhe mori pjesë në ceremoninë e vendosjes së kurorave në "Monumentin e Përpjekjeve Ndërkombëtare të Danimarkës që nga viti 1948". Ai më vete pati një takim me Madhërinë e Saj Mbretëreshën Margrethe II.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s u drejtua Sesionit të 73-të të Këshillit Nordik në Kopenhagë, më 3 nëntor 2021, ku nënvizoi rëndësinë e institucioneve të forta ndërkombëtare në ndërtimin e besimit dhe paqes midis kombeve. Stoltenberg tha se organizata si Këshilli Nordik, NATO dhe BE kanë ndihmuar në sigurimin e "paqes së thellë" të vendeve nordike që nga Lufta e Dytë Botërore dhe se kjo duhet të vazhdojë. Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti gjithashtu faktin që siguria dhe mbrojtja janë bërë temë për Këshillin Nordik pas shumë vitesh. Ai theksoi më tej se "NATO është aleanca më e suksesshme në histori" për shkak të "aftësisë sonë për t'u bashkuar dhe aftësinë tonë për të ndryshuar", dhe tha se "Ne do të kemi nevojë për më shumë, nga të dyja në vitet në vijim, sepse jetojmë në kohë të trazuar". Në përfundim Sekretari i Përgjithshëm theksoi se "Unë nuk besoj vetëm të Evropa. Unë nuk besoj vetëm të Amerika e Veriut. Unë besoj të Evropa dhe Amerika e Veriut së bashku, te NATO dhe në bashkëpunim me partnerët kryesorë. Duke qëndruar të bashkuar dhe duke vazhduar të përshtatemi për një botë në ndryshim, ne do të ruajmë "paqen e thellë" këtu në rajonin nordik dhe në Evropë."

I themeluar në vitin 1952, Këshilli Nordik është organi zyrtar për bashkëpunimin formal ndërparlamentar në të gjithë rajonin nordik. Aktualisht ai ka 87 anëtarë dhe puna e tij shtrihet në një sërë fushash, përfshirë legjislacionin dhe drejtësinë, zhvillimin e qëndrueshëm, dixhitalizimin dhe inovacionin, barazinë gjinore dhe çështjet LGBTI.

NATO, aleanca më e suksesshme në histori

Nga fjala e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg në Këshillin Nordik në Kopenhagë, Danimarkë

"Është kënaqësi të kthehem në Danimarkë dhe një nder i madh të flas këtu në Këshillin Nordik. Jam gjithmonë i lumtur që jam në Kopenhagë, në "Qytetin e Mbretit", duhet pranuar, për të takuar Mbretëreshën. Është gjithashtu një kënaqësi të diskutosh politikën e sigurisë. Për shumë vite nuk e kemi bërë këtë në këtë Këshill, por tani e bëjmë. Bertel përmendi babanë tim, Thorvald, në hyrje. Nëse ai do ta dinte që unë jam këtu duke folur për politikën e sigurisë, do të ishte shumë i lumtur, sepse ai kontribuoi në vendosjen e çështjeve të sigurisë dhe mbrojtjes në agjendën e Këshillit Nordik, një rrugëtim i gjatë. Jam i lumtur që jam këtu dhe takoj Këshillin Nordik. Unë kam kontribuar në forcimin e bashkëpunimit nordik për disa dekada, 25 vjet më saktë, si parlamentar, si ministër dhe si kryeministër. Më kujtohet, nganjëherë, isha pak i frustruar që vendimet

e marra nuk çonin gjithmonë në rezultate shumë konkrete. Jam i sigurt se kjo është diçka që ju e keni zgjidhur. Qeveritë janë më "on top" tani se sa ishin në kohën time. Pas dhjetë vjetësh si kryeministër i Norvegjisë dhe shumë vite në NATO, unë jam bërë një mbështetës edhe më i fortë i politikave që takohen në institucionet ndërkombëtare, siç është Këshilli Nordik, sepse ndërton besim, paqe dhe miqësi. Ne kemi nevojë për këtë në një kohë kur kombet duhet të bashkëpunojnë edhe më shumë. Ne jetojmë në paqe këtu në vendet nordike. Por historikisht, bashkëpunimi nuk ishte i dhënë për ne. Ne luftuam kundër njëri-tjetrit që nga epoka e vikingëve, përmes luftërave nordike, si në luftën e madhe nordike ashtu edhe të gjitha të voglat. Por tani jetojmë në paqe. Kjo nuk është vetëm falë Këshillit Nordik, ju me siguri luani rol në sigurimin e stabilitetit në rajon. Institucionet tona gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm kur bëhet fjalë për sigurinë. Nëse shikojmë pjesën tjetër të Evropës, ajo ishte gjithashtu e përfshirë nga lufta. Por tani është në paqe. Kjo mund t'i atribuohet institucioneve të krijuara pas Luftës së Dytë Botërore, përfshirë NATO-n dhe BE-në. Jam plotësisht i vetëdijshëm se jo të gjitha vendet nordike janë anëtarë të të dyja organizatave, por ne të gjithë përfitojmë nga stabiliteti që krijojnë këto institucione. Kjo do të thotë, për shembull, që vende si Islanda dhe Norvegjia, që nuk janë anëtare të BE-së, përfitojnë gjithashtu nga miqësia, besimi dhe paqja që Evropa ka ndihmuar në ndërtimin e vendeve si Gjermania dhe Franca. Kjo do të thotë që vende si Finlanda dhe Suedia, të cilat nuk janë anëtare të NATO-s, përfitojnë nga NATO që ofron kuadrin politik për sigurinë midis Amerikës së Veriut dhe Evropës. Pra, të gjitha vendet nordike përfitojnë nga institucionet e forta të ndërtuara pas luftës për të ruajtur paqen.

Lufta është e tmerrshme. Ne duhet të punojmë së bashku. Paqja është baza për gjithçka. Detyra jonë është të ruajmë këtë 'paqe të thellë', ta sigurojmë atë në pjesën tonë të botës. Ky është misioni i NATO-s: të ruajë paqen dhe të parandalojë luftën. Kjo është ajo që ne kemi bërë që nga viti 1949, kur u krijua NATO. Ne e kemi bërë këtë me sukses sepse kemi qenë në gjendje të ndryshojmë ndërsa bota përreth nesh ndryshoi. Për dyzet vitet e para, NATO kishte një mision të vetëm: të pengonte Bashkimin Sovjetik. Kjo zgjati nga viti 1949 deri në vitin 1979. Pastaj, pas Luftës së Ftohtë, ne u dhamë fund dy luftërave brutale etnike në Ballkan, në Bosnje dhe Kosovë. Pas sulmeve ndaj Shteteve të Bashkuara të 11 shtatorit 2001, ne kemi luftuar terrorizmin ndërkombëtar dhe pas aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia në 2014, ne kryem përforsimin më të madh të mbrojtjes sonë kolektive. Sot, ne përdorim shumë më pak burime dhe kemi shumë më pak ushtarë jashtë kufijve të NATO-s. Në të njëjtën kohë, ne po rrisim shpenzimet e mbrojtjes dhe po rrisim praninë ushtarake në territorin tonë, veçanërisht në rajonin e Balltikut. NATO është aleanca më e suksesshme në histori. Kryesisht për dy gjëra: aftësinë tonë për t'u bashkuar dhe aftësinë tonë për të ndryshuar. Ne do të kemi nevojë për më shumë nga të dyja në vitet në vijim, sepse jetojmë në kohë të trazuar. Moskë vazhdon modelin e saj të sjelljes agresive në disa frontet. Ajo ka investuar në mënyrë të konsiderueshme në



kapacitete të reja të avancuara ushtarake, përdori forcën ushtarake kundër fqinjëve, si dhe ndërhyr në punët e vendeve të tjera. Është veçanërisht shqetësuese që Rusia po vendos armë të reja bërthamore të avancuara. Kjo ka rezultuar në rënien e Traktatit INF, një nga marrëveshjet më të rëndësishme të çarmatimit. Qasja e NATO-s ndaj Rusisë ka dy pista: mbrojtje të fortë dhe parandalim të besueshëm, të kombinuar me dialog. Për herë të parë në historinë tonë, ne kemi vendosur grupe luftarake në lindje të Aleancës dhe rritëm gatishmërinë e forcave tona dhe të gjitha vendet e NATO-s po investojnë më shumë në mbrojtje. Në të njëjtën kohë, dera jonë mbetet e hapur për dialog politik. Na vjen keq për hezitimin e Rusisë për t'u takuar në Këshillin NATO-Rusi dhe vendimin e saj për mbylljen e dy zyrave të NATO-s në Moskë, dhe gjithashtu tërheqjen e personelit rus nga misioni i NATO-s në Bruksel. Sa më e vështirë të jetë marrëdhënia mes nesh, aq më e rëndësishme është të flasim me Rusinë. Jo më pak për kontrollin e armëve dhe çarmatimin. Ne mirëpresim marrëveshjen midis Rusisë dhe Shteteve të Bashkuara në fillim të këtij viti për të zgjidhur traktatin e New Start që kufizon armët bërthamore me rreze të gjatë. Puna për kontrollin e armëve duhet të vazhdojë dhe të përfshijë armë të reja dhe më shumë vende.

Një sfida tjetër është ngritja e Kinës. Ne e shohim atë në Arktik, në Afrikë dhe në hapësirën kibernetike. Kina së shpejti do të ketë ekonominë më të madhe në botë. Ajo tashmë ka marinën më të madhe në botë, buxhetin e dytë më të madh të mbrojtjes në botë dhe po investon shumë në armë të reja bërthamore me rreze të gjatë. NATO nuk e konsideron Kinën një kundërshtar. Por Kina është një superfuqi në rritje që nuk ndan vlerat tona. Një fuqi e madhe që shtyp, monitoron dhe kontrollon popullin e vet. Shtyp demokracinë dhe të drejtat e njeriut dhe persekuton pakicat etnike dhe fetare. Kina po kërcënon hapur Tajvanin dhe pengon lirinë e lundrimit, siç e kemi parë në Detin e Kinës Jugore.

Unë isha kryeministër i Norveg-

jisë kur Komiteti i pavarur i Nobelit, emëruar nga Parlamenti Norvegjez, i dha çmimin Nobel për Paqe aktivistit kinez për të drejtat e njeriut Liu Xiabo. Kina u përgjigj menjëherë. Ajo ndaloi çdo kontakt politik, bojktoi eksportet norvegjeze, dhe e bëri të qartë se do të bënte gjithçka për të kundërshtuar Norvegjinë. Danimarka pati një përvojë të ngjashme kur Dalai Lama u ftua këtu për një vizitë. Gjithashtu në Suedi, së fundmi kemi parë se si ambasada kineze ka kërcënuar gazetaret që shkruanin negativisht për Kinën. Këto janë vetëm disa shembuj se si Kina po përpiqet të dominojë vendet e tjera. Ndërsa Kina rritet, ne nuk duhet të bëhemi të varur prej saj. Pekini investon shumë në infrastrukturën kritike në vendet tona dhe në disa zona sot, furnizimet nga Kina janë jetike për shoqëritë tona. Nuk duhet të marrim kurrë si të mirëqenë rendin botëror ndërkombëtar me të cilin jemi mësuar, një rend botëror paqësor, i lirë dhe i bazuar në rregulla. Ne duhet të qëndrojmë së bashku, si vende demokratike, për të vazhduar të mbrojmë vlerat në të cilat besojmë dhe mbi të cilat NATO është ndërtuar, demokraci dhe liri.

Një sfida tjetër me të cilën përballlemi është kërcënimi i vazhdueshëm i sulmeve terroriste. NATO i ka dhënë fund pranisë sonë ushtarake në Afganistan, por lufta kundër terrorizmit vazhdon. Ishte një vendim i vështirë për t'u tërhequr. U përballëm me një dilemë: Qëndrojmë dhe rrezikojmë më shumë luftime dhe viktima civile, ose largohemi dhe rrezikojmë që talebanët të kthehen në pushtet. Pas konsultimeve të gjera, ministrat e Jashtëm dhe të Mbrojtjes të NATO-s vendosën në pranverë të këtij viti të largoheshin. Misioni ynë ishte i gjatë, kërkues dhe i kushtueshëm, në gjak dhe thesar. Qindra mijëra ushtarë kanë shërbyer në Afganistan gjatë dy dekadave të fundit. Shumë paguan çmimin përfundimtar, midis tyre, gjithsej 60 ushtarë nordikë. Shumë u plagosën rëndë edhe më shumë civilë dhe ushtarakë afganë u vranë. I nderoj dhe i falënderoj për sakrificat e tyre. Por përpjekjet tona në Afganistan nuk ishin të kota. Ne kemi bërë përparim të rëndësishëm në luftën kundër terrorizmit.

Ne e degruam Al-Kaedën dhe për 20 vjet, asnjë sulm terrorist nuk është nisur ndaj vendeve të NATO-s nga Afganistani. Tani, ne duhet të ruajmë atë që kemi arritur, për të parandaluar që Afganistani të bëhet edhe një herë një strehë e sigurt për terrorizmin ndërkombëtar dhe të vazhdojë përpjekjet globale kundër terrorizmit. Ne e bëjmë këtë, veçanërisht, përmes përpjekjeve tona në Irak. Ku ne trajnojmë dhe ndihmojmë forcat irakiane të sigurisë në luftën kundër IS. Ky është një mision i NATO-s i udhëhequr nga Danimarka. Një shembull tjetër se si Danimarka, si aleate e NATO-s, jep kontribute të rëndësishme për sigurinë tonë të përbashkët.

Ka edhe disa sfida të tjera, si kibernetike, ato që ne i quajmë sulme hibride, përhapijen e armëve bërthamore dhe ajo që diskutuam në Glasgow, ndryshimi i klimës dhe implikimet e saj për sigurinë tonë. Ndryshimi i klimës është një shumëfishues i krizës. Të gjitha këto sfida duhet të diskutohen në të njëjtin kuadër. Megjithatë janë sfida të ndryshme, ato ndajnë një bazë të përbashkët: Amerika e Veriut dhe Evropa së bashku mund t'i kapërcejnë. Të ndarë, do të dështojmë. Mesazhi më i rëndësishëm që kam për ju sot është se ne duhet të vazhdojmë të ruajmë bashkëpunimin historik që u krijua pas Luftës së Dytë Botërore. Ne kemi një mundësi historike. Ne kemi një administratë amerikane, një president të SHBA-së, i cili mbështet fuqimisht bashkëpunimin transatlantik, dhe dëshiron më shumë bashkëpunim me Evropën.

Ne shohim gjithashtu se SHBA ka rritur praninë e saj në Evropë. Nuk janë vetëm fjalë, janë edhe vepra. Një gjë për të cilën jam mjaft krenar gjatë kohës si Sekretar i Përgjithshëm në NATO është se ne, si aleatë, po punojmë edhe më afër se më parë. Shumë prej jush në këtë sallë e dinë se unë jam një mbështetës i madh i BE-së. Dy herë jam përpjekur të bind popullin norvegjez që të bëhet anëtar, të dyja herë dështova. Por unë kam një lloj anëtarësimi personal në BE, sepse BE-ja më fton shpesh si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s. Kështu që unë jam një anëtar personal krenar i BE-së. NATO dhe BE janë organizata të ndryshme, me anëtarë të ndryshëm, role të ndryshme dhe mjete të ndryshme. Por më shumë se 90 për qind e qytetarëve të BE-së jetojnë në një vend të NATO-s. Kemi të njëjtët fqinjë. Ne përballlemi me të njëjtat kërcënime sigurie dhe ne ndajmë të njëjtat vlera. Pra, ne tani po bashkëpunojmë më ngushtë se kurrë më parë dhe unë i kam thënë vazhdimisht BE-së se i mirëpres përpjekjet e saj të shtuara në mbrojtje. Por ajo që duhet të shmangim është krijimi i strukturave paralele, që do të përdorte të njëjtin grup, të kufizuar, burimesh që kemi tashmë. Po flasim për të njëjtët ushtarë, të njëjtat vende anëtare. Ne nuk do të jemi më të sigurt nëse zhvillojmë struktura të reja që konkurrojnë për të njëjtat aftësi. Kjo do të krijonte vetëm dyfishim dhe do të dobësonte NATO-n në vend që të forconte NATO-n.

Do të doja ta mbyllja thjesht duke thënë se nuk besoj vetëm në Evropë. Unë nuk besoj vetëm në Amerikën e Veriut. Unë besoj në Evropë dhe Amerikën e Veriut së bashku. Në NATO dhe në bashkëpunim me partnerët kryesorë. Duke qëndruar të bashkuar dhe duke vazhduar të përshtatemi me një botë në ndryshim, ne do të ruajmë "paqen e thellë" këtu në rajonin nordik dhe në Evropë."

KRYEREDAKTORE
ANJEZA MUSOLLARI

Femrat në karrierë, miti që theu tabutë

Koncepti i barazisë gjinore është tregues esencial social me të cilin mund të “matet” dhe vlerësohet niveli i emancipimit të shoqërisë shqiptare, qëndrimi i saj ndaj femrës dhe roleve të saj gjinore dhe qytetare. Natyrisht nuk mund të mohohet beteja që ka nisur në fushën e lirive dhe të drejtave të gruas në shoqërinë tonë. Madje tani intensiteti dhe sensibiliteti ka filluar të jetë në nivele më të larta se kurrë ndonjëherë. Por kjo “luftë” për barazi gjinore në shoqërinë tonë zhvillohet në një terren të caktuar social dhe politik, në të cilin shfaqen ndikime të fuqishme të natyrës gjeografike, psikologjike, mentale dhe sociale. Vendi ynë ndodhet në një rajon gjeografik të njohur në kontinentin tonë të vjetër të lirisë, demokracisë dhe emancipimit të femrës, për natyrën e thellë maskiliste, të shfaqur dukshëm si tendencë e caktuar e mbivlerësimit të rolit të burrit si forcë kryesore, me “peshë” socialo-prodhuese, duke nënvleftësuar rolin dhe peshën e gruas, gjinisë femërore në përgjithësi. Lufta për barazi gjinore zhvillohet për fatin tonë, në një terren psiko-social me bazë të fortë patriarkale, në të cilin ende qëndron i fuqishëm si “njësh”, koncepti masiv i rolit me epërsi të mashkullit, në të gjithë drejtimet mbi femrën. Pavarësisht ndryshimeve pozitive që kanë ndodhur, nuk mund të mos pranohet se në këtë fushë të respektimit të barazisë gjinore, si kusht i respektimit të të drejtave të gruas, ne ende jemi shumë larg standardeve europiane. Për fat të keq ne jetojmë në një shoqëri e cila shpesh e mban femrën të bllokuar në “grushtin e rreptë” të traditës maskiliste, të nënvleftësimit të rolit të saj në jetën sociale. Tradita e mbivlerësimit të burrit mbi gruan, vazhdon t’i qëndrojnë shoqërisë tonë si një “këmishë e hekurt” e cila e ka mbështjellë trupin e saj, me një membranë të fortë maskiliste, të vështirë për t’u “çliruar” nga konceptet moderne feministe të barazisë së plotë, të vërtetë dhe pa kushte gjinore. Barazia gjinore në punë është një çështje e rëndësishme, që ka ndikim si në perceptimin individual rreth arritjeve profesionale dhe zhvillimit në karrierë ashtu edhe në suksesin e organizatave. Meqenëse burimet njerëzore në ditët e sotme konsiderohen si burimi më i çmuar në organizata, trajtimi i tyre si të tillë dhe sidomos trajtimi i barabartë për nga ana e gjinisë dhe moshës është një çështje që ka ngritur polemika në të gjithë botën. Nisur nga kjo problematikë u nxita të zbuloj realisht masën e diskriminimit gjinor që ekziston në institucionet publike apo dhe private dhe duke ofruar disa rekomandime se çfarë mund të bëhet për të përmirësuar situatën sado pak. Studime të tjera të kohëve të fundit janë fokusuar kryesisht në nivelin e përgjithshëm të punësimit dhe duke u thelluar më pas në analizën e këtij niveli sipas gjinive. Vëmendje e veçantë i kushtohet të drejtave të femrave në punësim dhe masës së respektimit të këtyre të drejtave.

Shpesh karriera është definuar si “kursi apo përparim i një personi përgjatë jetës ose një pjesë të dallueshme të jetës”. Në këtë përkufizim kuptohet që karriera lidhet me një sërë aspektesh të jetës individuale të një personi, të mësuarit dhe të punës. Karriera është totali i të gjithë kontributeve të lidhura me punën, gjatë gjithë jetës së njeriut, që i atribuohet shoqërisë.

Një ndër faktorët që ndikon së tepërmi në llojin ose tipin e karrierës që zgjedhin individët është personaliteti ynë. Në këtë këndvështrim, një nga teoritë që shpreh me mirë përshtatjen/përputhjen e personalitetit me profesionin është teoria e Holland. Holland sugjeron që “Njerëzit



mund të funksionojnë dhe zhvillohen më mirë dhe të gjejnë kënaqësinë në punë, në ambientet e punës të cilat përputhen me personalitetin e tyre”. Menaxhimi i karrierës është procesi i marrjes së vendimeve lidhur me pranimin apo refuzimin e oportuniteteve të punës, në varësi të perceptimit të vlerës që kanë ato për arritjen e objektivave të karrierës. Ai përfshin jo vetëm vendimet e një individi por edhe ato të menaxherit apo të njerëzve të tjerë që kontrollojnë oportunitetet e punës për individin, për të realizuar qëllimin e vendosjes së njerëzve të duhur në vendin e duhur, në kohën e duhur.

Karriera tradicionale fokusohet në një seri progresive të hapave drejt hierarkisë ndaj pozicioneve në rritje të autoritetit dhe të përgjegjësisë. Gjithashtu në një karrierë lineare tradicionale, punëdhënësi merr përsipër shumë përgjegjësi për menaxhimin dhe zhvillimin e karrierës dhe i jep punonjësve më tepër siguri në punë. Format e reja të karrierës përbëhen nga disa tipa të tjerë, shembulli më tipik i të cilave është karriera “proteane”. Karriera proteane fokusohet në vetë-menaxhimin dhe besnikërinë ndaj vetvetes (vlerat vetjake kundrejt vlerave të organizatës). Këto forma të reja të karrierës përfshijnë më pak besnikëri ndaj punëdhënësit, vetë-menaxhimin e karrierës dhe ndryshimet në punë ose disiplinat e punësimit. Si rrjedhojë punonjësit që preferojnë këto tipa karriere mund të përkufizohen si “të pavarur” nga strukturat punëdhënëse. Një tjetër dallim lidhet me rëndësinë që një individ i jep karrierës. Ndërkohë që tipat linear dhe jo linear së bashku e konsiderojnë karrierën të rëndësishme për jetën e tyre, mund të ketë gjithashtu edhe një tip që nuk i jep rëndësi

të madhe jetës së punës ose që reflekton një mos përkushtim ndaj karrierës si një interes kyç në jetë ose edhe më tej.

Në barazinë midis burrave dhe grave, theksohet se prezenca e grave menaxhere në kompani po përparon shumë ngadalë dhe ka mbetur në nivelin 33%. Në sektorin privat drejtimi i bizneseve nga gratë është në nivele të ulëta. Sipas statistikave të INSTAT, vetëm 17% e drejtuesve të biznesit privat janë gra dhe vajza, ku numri më i madh i tyre është i përqendruar në zonat urbane 85% dhe më pak në zonat rurale me 15%. Një përfaqësim kaq i ulët është i kushtëzuar nga shumë faktorë socialë-kulturorë, por edhe nga ndikimi i ulët i institucioneve shtetërore dhe financiare, të cilat nuk i krijojnë mundësi apo mbështetjen e duhur favorizimit të sipërmarrjes së biznesit nga gratë dhe vajzat. Një studim i bërë në Harvard tregoi se rendimentet profesionale të grave janë më të mira se ato të kolegëve meshkuj. Në fakt bankat e vetme që nuk janë përfshirë në krizën e kredive janë ato që kanë gra në pozicione drejtuese. Gratë kanë një raport më racional me paranë, më pak emotive dhe janë më shumë të prirura ndaj kursimeve. Pavarësisht ndryshimeve që kanë pasuar zhvillimin e gruas sot, jo vetëm në Shqipëri por edhe në botë, ende vihet re një hendek mes kapacitetit dhe nevojave të tyre dhe burimeve që ato disponojnë; arsimimit, punësimit, përfshirjes në vendim-marrje. Niveli i ulët i përfaqësimit të gruas në vendimmarrje është një çështje e ndikuar nga shumë faktorë socialë-kulturorë, ekonomikë, strukturorë, shoqërorë etj. Sot pas afërsisht 100 vjetësh nga fitimi i të drejtës

së votës dhe të drejtës për t’u zgjedhur, gratë në Shqipëri kanë një nivel shumë të ulët përfaqësimi në nivel vendimmarrës.

Barazia gjinore nuk është një çështje e grave, siç cilësohet, por është një çështje e barazisë mes grupeve të burrave dhe grave, e shanseve të barabarta mes tyre në të gjitha fushat e jetës nga drejtimi i familjes tek qeverisja e një shteti. Ajo është një proces integrimi që synon zhvillimin e shoqërisë, në nivelin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në nivel social, në nivel të drejtash civile dhe politike duke pasur mundësi të barabartë për të ushtruar të drejtën për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur. Dallimet gjinore në vendin e punës mund të përdoren si një tregues i barazisë gjinore. Gratë nuk trajtohen në mënyrë të ndershme në tregun e punës dhe përballojnë pengesa indirekte të tilla si stereotipet dhe diskriminimi gjinor. Diskriminimi është një sjellje e dukshme me anë të së cilës njerëzit trajtohen ndryshe dhe jo në mënyrë të favorshme për shkak të racës, klasës, gjinisë apo statusit kulturor të tyre. “Në terminologjinë e Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Gruas” (CEDAË), konsiderohet si përjashtim, pengesë, apo dallim i bërë në bazë të seksit, që ka si qëllim apo efekt mohimin e ushtrimit të barabartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në të gjitha fushat e përpjekjeve njerëzore. Në nenin 11 të saj, konventa specifikon detyrimet e shteteve palë në fushën e punësimit duke kërkuar që shtetet palë të marrin të gjitha masat për eliminimin e diskriminimit të gruas në fushën e punësimit. Po në strukturat e Forcave të Armatosura si ruhet diversiteti? Simbioza gjinore në punë?.....

"Skënderbegasit"

Në panteonin e vlerave të kombit shqiptar

PUNOI: ANJEZA MUSOLLARI

Skuadra e Partizanit, është krenari e sportit të ushtrisë sonë dhe e sportit shqiptar. Ajo ishte një nga kandidatet më të forta për fitimin e titullit kampion në kampionatin kombëtar të futbollit.

Qysh nga fund-dimri 1947, për rreth 25 vjet, nga mikrofonin i Anton Mazrekut, nuk do të kishte skuadër që do të përmendej më fort se ky klub me emrin "Partizani"...

Partizani, ndryshe Skuadra e Ushtrisë Kombëtare apo Popullore, siç do të thirrej pak më mbas. Rrallë mund të gjendet një rast kësajsoj në historinë e futbollit botëror, që krijimi i një klubi të ri futbollit të ndikonte aq fort në ecurinë e kampionateve të një vendi si ky i Shqipërisë.

Kampionati i 10-të Kombëtar i Shqipërisë kishte fituar mjaft elemente të rinj, kishte "humbur" Kombëtares si Kampione të Ballkanit, kishte lindur Partizani ushtarak, kishte shkatërruar skuadrën më legjendare që kishte pasur Shqipëria deri atëherë, Sportklub Tiranën alias 17 Nëntorin. Partizani 29 pikë, Vllaznia 28, Dinamo e Korçës 24.

Kjo ishte renditja përfundimtare e treshes së parë. Çfarë Partizani ishte ky kampion i ri, qysh në pjesëmarrjen e tij të parë? Gazeta "Sporti" e përcakton kështu: "Kjo fitore e ndritshme e 'Partizanit' tregon me një fakt të ri se ç'hoj të madh ka marrë fizikultura në Ushtrinë Kombëtare. Dhe skuadra e Partizanit e arriti objektivin e vet duke u përshkuar nëpër një përparim gradual dhe të sigurt. Loja e tij gjatë ndeshjeve të kampionatit, fitoi gjithnjë e më tepër forcë, vitalitet, stil, harmoni dhe pikërisht në periudhën e sulmit përfundimtar për të fituar titullin kampion, skuadra ushtarake që në të njëjtën kohë ishte edhe skuadra shembullore e rregullit, e disiplinës, e vëllazërimit, erdhi në një formë të shkëlqyer".

Madhështia e fanelës së kuqe në fushën e blertë

Në panteonin e yjeve të skuadrës së Partizanit do të zinte vendin e tij dhe Ramazan Njala

Dhe pse jo fizikisht pranë familjarëve, sportdashësve apo adhuruesve të artit të tij, Ramazan Njala ka mbetur gjithmonë i gjallë dhe i paharrueshëm për cilindo që e ka njohur nga afër...

Ramazan Njala lindi në lagjen "Kala" të qytetit të Durrësit, më 20 shkurt 1922, Fillimet sportive të Ramazanit shënohen në vitin 1945, kur gjatë kohës së shërbimit ushtarak aktivizohet si futbollist me ekipin e Gjirokastrës, kohë në të cilën do të dilnin në pah edhe lidhjet e tij me humorin që i buronte së brendshmi e bëhej pjesë e shoqërisë. Meqenëse identifikohet si sportist me të ardhme, në vitin 1946 aktivizohet portier me ekipin e futbollit të Partizanit për 2 vjet rresht, vite kur ekipi ishte kampion i republikës. Nuk mbetet vetëm te futbollit. Cilësitë e tij sportive vlerësohen dhe shfrytëzohen në lojërat e para ballkanike, ku ai shfaqet si volejbollist



me ekipin kombëtar. E donte Durrësin, qytetin e tij dhe shpirti lokalist e kthen Ramazanin në vitin 1948 në qytetin e lindjes, ku për vite e vite me radhë aktivizohet me ekipin e Lokomotivës në volejboll, basketboll, not, vaterpolo, atletikë, hendboll, trajner me të rinjtë e gjyqtar deri i ndeshjeve të kategorisë së parë. Për aftësitë dhe cilësitë e mira që kishte e kanë quajtur si lojtari më i mirë i kohës, duke e vlerësuar me tituj e stimuj të ndryshëm, ku përmenden "Medalja e punës" dhe Urdhri "Naim Frashëri". Në vitin 1956, për arritje të rezultateve të larta dhe normave sportive, ndër të parët sportistë merr titullin "Mjeshtër sporti". Ramazan Njala është aktivizuar gjithnjë në pesëshen e parë, krahas sportistëve të tjerë të mëdhenj e me shumë emër.

Sot, Pallati i Sportit i qytetit bregdetar dhe një rrugë e hershme e Durrësit mbajnë emrin e Ramazan Njalës. Në vitin 2002 Këshilli Bashkiak i akordoi titullin "Nderi i qytetit", ndërsa në vitin 2012 Presidenti Bamir Topi e dekoroi me Titullin "Mjeshtër i madh" (pas vdekjes).

26 vite aktivitet të pandërprerë sportiv e bënë Ramazanin mjaft popullor e të njohur. Ky fakt dhe humori në komunikim e ndihmon të ngjisë me lehtësi, pas vitit '60, shkallët e një fushe tjetër, po kaq të dashur për njerëzit e pasionantë për të, estradës, së cilës i shërbeu me pasion deri në fund të jetës së tij. Që nga krijimi i trupës së estradës profesioniste të Durrësit, Ramazani mori pjesë në 46 premiera të saj, me një galeri të tërë tipash e personazhesh në rreth 90 role, si fshatar, punëtor, intelektual, i sëmurë etj. Ai u nda para kohe nga jeta, në moshën 60-vjeçare, pas një sëmundjeje të rëndë, në 24 shtator të vitit 1982.

Mikel Janku, piloti që u bë portier i Partizanit dhe Kombëtares

Nga një karrierë ushtarake, tek një tjetër e famshme, sportive. Nga një pilot helikopteri mbi Vollga e Don, në një portier i shquar i futbollit shqiptar. Mikel Janku, aviatori, portieri i kombëtares, kampioni dhe fituesi i kupave me Partizanin, opinionisti, gazetari, vëllai i madh i familjes, të gjithë protagonistë me një klub të vetëm?

Ishti nxënës i shkëlqyer i vitit të tretë, kur e kanë përzgjedhur të jetë në kursin e aviacionit në Shkollën Skënderbej. Vetëm një herë në qiell nga fusha e aviacionit në Shijak, me "Jak 18", një avion i shpejtë, prodhim rus i luftës së dytë botërore. Ndonëse rrotat nuk janë hapur në zbritje e kanë detyruar të qëndrojnë 45 minuta në ajër. Ishte viti 1958, muaji korrik dhe kur ende nuk ka bërë 17 vjeç, i ka hipur vaborit "Bjelloostrov" për në Odesë. I përcjellë nga familjarët, me dëshirën për të shkuar e studiuar për tri vite në shkollën e njohur të fluturimit në Bashkimin Sovjetik, fillimisht në Pugacov, pastaj në Batack të Rostovit, ku specializohet si pilot për helikopterë transporti. Fluturime në zonën e Vollgës, në hapësirat mbi Don, hedhje me parashutë, ndërkohë që ushtronte sport e fliste mirë rusisht. Luan me shkollën si portier, por edhe basketboll, gjimnastikë, ski, patinazh në akull. Ndiqte kampionatin rus, tifoz i "Partizanit", që para nisjes nga Shqipëria dhe i Rostovit e CSKA Moskës. Admironte futbollist legjendar rus, Viktor Poniedelnik.

I datëlindjes '41, i pari i katër vëllezërve Janku, ndonëse jo shtatlartë, ka qenë një portier tej mase elastik, akrobat, modern për kohën, duke sjellë një filozofi të re në lojën portierëve në dalje të guximshme nga porta në topat ajrorë. Luante me dorën e majtë dhe godiste me këmbën e djathtë në të cilën vendoste një kavilieri të bardhë që e mbante pas një dëmtimi kohë më parë. Kur erdhi tek Partizani gjeti një kolos në portë, Sulejman Maliqatin, momentet vendimtare me të cilin e lidhin janë dy: Në prill të 62-shit për Kupën e 60-të Vjetorit të Çlirimit, në stadiumin "Dinamo", Maliqati ka bërë edhe nxemjen, por i dëmtuar pak para se të fillojë takimi i thotë Boriçit se ka shqetësime. "Nuk ka problem, zhvishu" – i drejtohet Jankut, që shënon debutimin e tij me Partizanin. Në shtator të 62-shit, ndërsa Maliqati aktivizohet luan në Suedi ndaj Norceping, në ndeshjen e kthimit është i dëmtuar. Ndërsa skuadra është e grumbulluar, kur trajner Spahiu i thotë Jankut të përgatitet dhe në Partizani-Norceping 1-1 (gol Kindrall 9' dhe Kraja 50'), në portë është ai. "Si ëndërr e shoh ende dhe jo sikur ta kem luajtur atë ndeshje", – thotë Janku. Pa përvojë në futbollin e madh shqiptar, me aktivizime sporadike e pa asnjë ndeshje të plotë, ka qenë vetëm 21 vjeç kur ka debutuar në Kupën e Kampioneve. Pastaj në kampionat, kundër Spartakut dhe Këlnit dhe kur në shtatorin e 1964 legjenda Maliqati largohet përfundimisht nga Partizani, porta e klubit të famshëm do të ketë një tjetër protagonist: Mikel Jankun.

Portier i kombëtares është e kufizuar vetëm në tre vite: 1964-1967, duke luajtur 9 takime zyrtare të FIFA-s e UEFA-s. Ka debutuar në Rotterdam, në majin e vitit 1964, Holandë-Shqipëri 2-0, i aktivizuar nga trajneri Zyber Konçi. Pastaj, në sfidën e kthimit me "portokallinjët", dy herë me Zvicrën, kundër së cilës kujton penalltinë inekzistente që dha arbitri, pas një devijim i topit për kornë. Ndërsa futbollistët e kujtuan për goditje këndi, vërshëllima e tij urdhëronte për 11-të metërsh. Por edhe Irlandën e Veriut, në veçanti është titullar në "Qemal Stafa" në atë 90-të minutësh histori pas barazimit 1-1. Në prill të 1967, në Dortmund, RF Gjermane-Shqipëri 6-0, për të vijuar në Tiranë, më 14 maj Shqipëri-Jugosllavi 0-2 dhe kjo është edhe ndeshja e fundit e Jankut në portën e kombëtares, pasi në Jugosllavi-Shqipëri 4-0, me 12 nëntor në portë do të jetë Jani Rama. Për sfidën e 17-dhjetorit të 67-tës ndaj RFGJ-së, Boriçi do të zbulojë Koço Dinellën, ndërsa Janku do të jetë rezervë e tij. Mund të jetë rasti i vetëm ky, kur katër vëllezër kanë luajtur me një klub të vetëm, si Mikel, Virgjil, Agim dhe Vladimir Janku, të gjithë me Partizanin.



10 marinat më të fuqishme në botë

Gazeta "Ushtria do të botojë në numrat e ardhshme marinat më të fuqishme në botë"

Marina Ruse

Pas rënies së Bashkimit Sovjetik, marina ruse trashëgoi flotën e saj nga marina sovjetike. Që nga fillimi i viteve 1990 me përfundimin e Luftës së Ftohtë dhe problemet e vazhdueshme të financimit, flota ruse është zvogëluar ndjeshëm në madhësi. Shumica e anijeve të saj janë relike të epokës së Luftës së Ftohtë. Gjatë dy dekadave të fundit marina ruse përballlet me probleme të vazhdueshme në ruajtjen e anijeve të saj luftarake kryesore për shkak të fondeve të kufizuara. Edhe pse mbetet një forcë jashtëzakonisht e frikshme me rreth 140 000 personel, anije luftarake dhe nëndetëse të shumta.

Marina ruse operon me një aeroplanmbajtës të vetëm "Admiral Kuznetsov". Nuk është aq i aftë sa transportuesit amerikanë dhe mbart më pak avionë. Megjithatë mbetet një anije madhështore dhe e frikshme. Shërbimi i anijes "Admiral Kuznetsov" në marinën ruse është i rrënuar me aksidente të ndryshme dhe rrëzime avionësh. Ka probleme me sistemin shtytës të anijes. Rusia padyshim që lufton të mbajë transportuesin e saj të vetëm të avionëve dhe ta mbajë atë në funksion. Nuk ka plane të menjëhershme në Rusi për të ndërtuar një pasardhës për këtë anije.

Marina ruse operon me një kryqëzor beteje të vetëm "Petr Veliky", por me sa duket gjithsesi po lufton për të ruajtur këtë luftanije masive. Gjithashtu ka 3 kryqëzorë më të vegjël të klasit "Slava" që kanë aftësi të shkëlqyera kundër anijeve, kundërajrore dhe anti-nëndetëse.

Ka rreth 15 shkatërrues, përfshirë shkatërruesit e luftës kundër nëndetësive të klasit "Udaloy" dhe shkatërruesit e qëllimit të përgjithshëm të klasit "Sovremenny". Gjithashtu ka rreth 9 fregata dhe 24 korveta.

Forca detare ruse nuk është aq e madhe dhe ka vetëm rreth 12 000 personel. Marinsat dërgohen në breg nga një anije e vetme transporti amfib e klasit "Ivan Gren". Ka 15 anije të tjera zbarkuese të klasit "Ropucha I" dhe "Ropucha II" dhe 4 anije zbarkuese të klasit "Alligator". Këto anije ofrojnë aftësi amfibe me rreze të gjatë. Sidoqoftë, transportuesit amfibë rus janë shumë më të vegjël dhe më pak të aftë se homologët e tyre amerikanë.

Marina ruse operon një numër të nëndetësive sulmuese me energji bërthamore. Ekziston një numër anijesh të klasit "Akula" me energji bërthamore, që përbëjnë rreth gjysmën e flotës së nëndetësive sulmuese me energji bërthamore të Rusisë. Disa anije të reja të klasit "Graney" me energji bërtham-

ore janë duke u ndërtuar. Ekzistojnë gjithashtu 3 nëndetëse raketash të klasit "Oskar II". Këto janë nëndetëset më të mëdha të sulmit të ndërtuara ndonjëherë dhe kanë për qëllim të sulmojnë grupet luftarake të transportuesve të avionëve amerikanë dhe instalimet bregdetare. Gjithashtu ka nëndetëse patrullimi të klasit "Kilo", të përdorura për mbrojtjen e bazave detare.

Duket se marina ruse po investon shumë në nëndetëset e saj të reja të raketave balistike të klasit "Borei". Gjithsej 3 nga këto anije janë në shërbim ndërsa 5 të tjera po ndërtohen me një ritëm mjaft të shpejtë. Këto anije mbajnë raketa ndërkontinentale me majë bërthamore. Ekzistojnë disa anije më të vjetra të raketave balistike të klasit "Delta IV" që gjithashtu paraqesin një kërcënim të rëndësishëm. Vlen të përmendet se nëndetëset më të vjetra ruse të të gjitha llojeve mund të kenë gatishmëri më të ulët për shkak të financimit të pamjaftueshëm.

Në teori, marina ruse humbet


ndaj marinës kineze për sa i përket numrit dhe tonazhit të anijeve luftarake. Sidoqoftë, marina ruse operon një numër nëndetësesh të provuara

dhe jashtëzakonisht vdekjeprurëse të raketave balistike.

Aviacioni detar rus operon rreth 360 avionë, duke përfshirë një numër

të vogël avionësh luftarakë anti-nëndetëse me rreze të gjatë Tu-142, avionë luftarakë me rreze të mesme Il-38 dhe bombardues taktikë Su-24.





“Nuk mund të zhbëjmë të kaluarën e as ta kthejmë kohën mbrapa për të adresuar krimet që duhej të ishin adresuar kohë më parë, por mund të bëjmë më të mirën në rrethanat në të cilat jemi. Shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, krimet e luftës, do të trajtohen nga mekanizimi për dokumentimin e krimeve të kryera”, -ka thënë Kurti.



Koncept-dokumenti

Kryeministri Kurti: Nuk mund të zhbëjmë të kaluarën e as ta kthejmë kohën mbrapa, por mund të bëjmë më të mirën në rrethanat në të cilat jemi

“Të vrarët nga dora gjakatare serbe”

Qeveria e Kosovës ka miratuar Koncept-dokumentin për themelimin e mekanizmit për dokumentimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë.

Kryeministri Albin Kurti gjatë mbledhjes tha se kanë kaluar 22 vite pas luftës, dhe adresimi i krimeve të kryera gjatë luftës është shumë larg prej asaj që ne duam e na duhet.

“Nuk mund të zhbëjmë të kaluarën e as ta kthejmë kohën mbrapa për të adresuar krimet që duhej të ishin adresuar kohë më parë, por mund të bëjmë më të mirën në rrethanat në të cilat jemi. Shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, krimet e luftës, do të trajtohen nga mekanizimi për dokumentimin e krimeve të kryera”, -ka thënë Kurti.

Kurti ka shtuar se koncept-dokumenti rekomandon themelimin e mekanizimit me anë të një ligji



të veçantë.

“Ky mekanizëm do ti kontribuojë realizimit të së drejtës së viktimave dhe shoqërisë për të ditur të vërtetën. Dokumentimi i krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë do t'i shërbejë edhe edukimit të ngritjes së vetëdijes që vendi, unë dhe rajoni kurrë mos të shohë më përsëritjen e dhimbshme të krimeve të kryera”, -tha Kurti.

Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu u shpreh se “Qëllimi i krijimit është që krimet që kanë ndodhur të mblidhen, të verifikohen dhe të jenë të qasshme për viktimat, për shoqërinë dhe pastaj për institucionet e drejtësisë”

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj: Karta e Adriatikut-SHBA, adresa e radhës në rrugën tonë drejt anëtarësimit të Kosovës në NATO

Karta e Adriatikut-SHBA, adresa e radhës në rrugën tonë drejt anëtarësimit të Kosovës në NATO.


Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, me ftesë të homologut të tij kroat, Mario Banozic, ka udhëtuar për në Split të Kroacisë, për të marrë pjesë në takimim vjetor të ministrave të mbrojtjes të Kartës së Adriatikut-SHBA (A5), që këtë vit është nën Presidencën e Kroacisë.

Me këtë rast, ministri Mehaj theksoi se pjesëmarrja në këtë takim është mundësi e shkëlqyeshme për të prezantuar fuqishëm nevojën për pranimin e Kosovës me statusin e barabartë në këtë organizatë. “Kërkesa ime bazohet në faktin e natyrshëm duke pasur



parasysh se siguria dhe mbrojtja në mjedisin aktual të sigurisë rajonale nuk mund të arrihet e fragmentarizuar, por me qasje proaktive të të gjitha vendeve mbi konceptin e përgjithshëm të bashkëpunimit

të ngushtë rajonal”, -theksoi ministri Mehaj. Ai gjithashtu shtoi se tashmë është dëshmuar edhe konkretisht Republika e Kosovës është e gatshme dhe e përgatitur për të dhënë kontributin efektiv në kuadër të kësaj organizate dhe bashkimit të afërm me partnerët tjerë në NATO.



“Telashet për një buxhet më të madh dhe një rëndësi më të madhe të Armatës u shpërblyen sepse pamë se sa shumë ushtria jonë mund të rritet, zhvillohet dhe do të mbajë me krenari emrin e Armatës së NATO-s. Shtipi duhet të jetë veçanërisht krenar për këtë. “Sot është një rastësi e mirë që jemi këtu dhe e kemi vënë atë vulë në rëndësinë e Shtipit pikërisht në ditën kur qyteti feston ditën e çlirimit të tij”, tha Shekerinska, duke nënvizuar se grupi i Batalionit të Lehtë të Këmbësorisë do të “mbrojë” ngjyrat e atdheut tonë në NATO.



Ministrja Radmila Shekerinska:

“Nuk është rastësi që një nga pesë vendet që kanë marrë këtë mbështetje është pikërisht Maqedonia e Veriut”

Ministrja Radmila Shekerinska mori pjesë në ceremoninë me rastin e fillimit të stërvitjes së Grupit të Batalionit të Lehtë të Këmbësorisë me vendndodhje në kazermën “Jane Sandanski” në Shtip, të cilin do ta kryejë Brigada Amerikane për Asistimin e Forcave të Sigurisë, e njohur si “4th SFAB” apo “Security Forces Assistance Brigade”.

Në ceremoninë ku morën pjesë ambasadorja amerikane Kejt Mari Bërn, ekipi i SFAB, shefi i Shtabit të Përgjithshëm Vasko Gjurchinoski dhe përfaqësues të tjerë të Armatës, si dhe nga ambasada e SHBA-së, ministrja u shpreh e kënaqur që Maqedonia e Veriut është një nga pesë vendet evropiane që përdorin këtë ndihmë amerikane.

“Kjo është hera e parë që ushtria amerikane përdor Brigadën e 4-të për të ndihmuar forcat e sigurisë në Evropë. Nuk është rastësi që një nga pesë vendet që kanë marrë këtë mbështetje është pikërisht Maqedonia e Veriut”, -tha Shekerinska.

Ajo u shpreh se stërvitja amerikane është një nga më prestigjiozot në botën e aftësive ushtarake dhe përgëzoi GBLK-në dhe Batalionin e Inxhinierisë që patën mundësinë të rriten profesionalisht dhe të ngrihen nën mentorimin e Brigadës.

“Jam e bindur se ky bashkëpunim do të përfundojë me sukses dhe se kurora e vërtetë do të jetë vlerësimi i NATO-s për këtë përbërje të rëndësishme”, -tha ministrja Shekerinska.

“Telashet për një buxhet më të madh dhe një rëndësi më të madhe të Armatës u shpërblyen sepse pamë se sa shumë ushtria jonë mund të rritet, zhvillohet dhe do të mbajë me krenari emrin e Armatës së NATO-s. Shtipi duhet të jetë veçanërisht krenar për këtë. “Sot është një rastësi e mirë që jemi këtu dhe e kemi vënë atë vulë në rëndësinë e Shtipit pikërisht në ditën kur qyteti feston ditën e çlirimit të tij”, tha Shekerinska, duke nënvizuar se grupi i Batalionit të Lehtë të Këmbësorisë do të “mbrojë” ngjyrat e atdheut tonë në NATO.

Në fjalën e saj, ambasadorja Bërn theksoi se zgjedhja e Maqedonisë së Veriut për të marrë mbështetje nga SFAB pasqyron reputacionin e jashtëzakonshëm të oficerëve të ushtrisë, nënoficerëve dhe ushtarëve si partnerë të përgatitur dhe të aftë.

“Ngjarja e sotme është një festë e një arritjeje të rëndësishme në marrëdhëniet për bashkëpunimin e mbrojtjes mes dy kombeve. Në procesin e të menduarit të



udhëheqësve të lartë se ku të angazohet më së miri Brigada Mbështetëse e Forcave të Sigurisë, nuk është çudi që një nga pesë vendet që ata zgjedhën ishte Maqedonia e Veriut. Kjo është një kohë vendimtare, pasi ju të gjithë kaloni nëpër modernizimin dhe transformimin historik ushtarak për të përmbushur Objektivat e Aftësisë së NATO-s,” -tha ambasadorja Bërn.

Në këtë ngjarje foli edhe komandanti i Komandës Operative Besnik Emiri, i cili tha se kjo ndihmë rrit efikasitetin ushtarak dhe përfitimet e përgjithshme për vendin.

SHBA dërgon 40 instruktorë të ndarë në tre ekiye, të cilët do të qëndrojnë në Maqedoninë e Veriut deri në fund të marsit.

Shekerinska nga takimi ministror i SEDM: Sfidat e përbashkëta kërkojnë përgjigje të përbashkët

“Pandemia, ndryshimet klimatike që kanë rezultuar në fatkeqësi natyrore si zjarre dhe përmytje shënuan vitin e kaluar. “Lajmet e rrejshme dhe dezinformatat që kanë rënduar të gjithë rajonin, rruta e emigrantëve që kalon nëpër rajonin tonë, kërcënimet hibride dhe kibernetike – asnjë nga këto çështje nuk do të zgjidhet vetvetiu”, tha ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska në fjalimin e saj para ministrave të mbrojtjes dhe përfaqësuesve të lartë të vendeve anëtare të iniciativës SEDM, në takimim e sotëm ministror në Shkup.

Ministrja bëri thirrje për veprim dhe lidhshmëri secilin prej vendeve të rajonit sepse sfidat e përbashkëta kërkojnë një përgjigje të përbashkët dhe të bashkuar.

Shekerinska theksoi se mësimi më i rëndësishëm i nxjerrë nga të gjitha krizat me të cilat është përbashkët rajoni është se asnjë vend nuk mund të merret me to vetë, pavarësisht sa i pajisur është.

“Këtë verë, nga zjarret u përfshi edhe Maqedonia e Veriut. Aktivizua jo vetëm forcat civile, por edhe ato të ushtrisë për shuarjen e zjarreve, helikopterët tanë të ushtrisë ishin çdo ditë në terren, bëmë maksimumin, vumë në dispozicion të gjitha objektet e ushtrisë, por kjo nuk mjaftoi për të frenuar zjarrin. “Po të mos ishin miqtë tanë nga Sllovenia, Serbia, Rumania, Bullgaria, Austria dhe Mali i Zi, pasojat e zjarrit do të ishin dukshëm më të mëdha”, tha ministrja, duke falënderuar për reagimin e shpejtë dhe mbështetjen e sigurtë në përbashkët me zjarret.

Lidhur me interesimin e Maqedonisë së Veriut për bashkëpunim të zgjeruar rajonal, ministrja Shekerinska theksoi se anëtarësimi në NATO asnjëherë nuk do të thotë se vendi do të humbasë interesin për fqinjët e saj dhe për rajonin më të gjerë.

Lidhur me interesimin e Maqedonisë së Veriut për bashkëpunim të zgjeruar rajonal, ministrja Shekerinska theksoi se anëtarësimi në NATO asnjëherë nuk do të thotë se vendi do të humbasë

interesin për fqinjët e saj dhe për rajonin më të gjerë.

“Takimi i sotëm është konfirmim i drejtpërdrejtë i interesit tonë të përbashkët për krijimin dhe zhvillimin e miqësisë, për të forcuar lidhjet tona institucionale dhe besimin mes nesh”, tha ministrja Shekerinska.

Kryetari i iniciativës SEDM, Plamen Jordanov, në fjalën e tij falënderoi vendin tonë dhe ministren Shekerinska për organizimin e takimit. Jordanov iu referua edhe qëllimeve gjatë presidencës së Sofjes me iniciativën SEDM, si nxitja e bashkëpunimit të ndërsjellë, mirëkuptimi ndërmjet vendeve anëtare, kontributi për paqen dhe sigurinë në rajon, forcimi i kapaciteteve dhe ndërveprueshmërisë së SEEBRIG-ut, bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare. OKB, BE, NATO dhe OSBE dhe zgjerimi i SEDM me anëtarë të rinj. Takimi SEDM i organizuar nga Maqedonia e Veriut mblodhi së bashku ministrat dhe përfaqësues të mbrojtjes nga vendet e Evropës Juglindore.

Qëndrimi burrëror i Themistokli Gërmenjit

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Forcat patriotike

ngritën popullin në këmbë

Shqipëria në Luftën e Parë Botërore u bë shesh beteje, midis forcave ndër-luftuese. Ushtritë italiane dhe franceze, kishin zënë Shqipërinë e Jugut, kurse ushtritë austro-hungareze dhe bullgare, Shqipërinë e Mesme. Në Korçë, ishin vendosur forcat pushtuese greke. Rreziku i copëtimit dhe i aneksimit të Shqipërisë së Jugut, nga shovinistët grekë, ishte tepër i madh. Pikërisht në këtë periudhë kaq të vështirë, forcat patriotike ngritën popullin në këmbë, për t'i dalë zot vendit. Në krahinë e Korçës, vepronin çetat e Themistokli Gërmenjit dhe të Sali Butkës. Patrioti Themistokli Gërmenji, duke përfutur nga rasti i shtrirjes së ushtrisë franceze në Korçë dhe në qarkun e saj, ngriti një komision dhe në emër të popullsisë së krahinës, u kërkuan forcave franceze, largimin e grekëve nga Korça dhe ngritjen e një administrate shqiptare. Autoritetet franceze të pushtimit, u ndodhën përballë një lëvizjeje të fuqishme patriotike shqiptare, që kërkonte me çdo kusht largimin e pushtuesve grekë, nga Korça. Francezët ishin të interesuar të shuanin "vatrat e zjarrit" dhe të kishin siguri e qetësi, në prapavijat e tyre. Për këtë arsye, komandanti francez i zonës së Korçës, koloneli Dekoen, sipas udhëzimeve të komandës së "Armatës së Lindjes", vendosi të largonte nga Korça, venizelistët grekë dhe hyri në bisedime.

Korça paraqiste interes të veçantë për të dy bloqet ndër-luftuese, si në aspektin politik ashtu dhe ushtarak. Ajo ndodhej në ndërprerjen e udhëve midis Shqipërisë, Greqisë e Serbisë dhe ishte kanali më i përshtatshëm i komunikimit midis Fuqive Qendrore dhe Pallatit Mbretëror të Athinës. Midis frontit të "Armatës së Lindjes" dhe forcave italiane ishte krijuar një boshllëk i cili pa pushtimin e Korçës dhe të zonave të saj nuk mund të mbushej. Trupat franceze kishin marrë detyrën për mbulimin e një pjese të rrugës Sarandë-Korçë, rrugë strategjike për Antantën. Më 22 qershor 1916 filluan veprimet e para pushtuese nga ana e francezëve. Në nëntor të vitit 1916, trupat franceze kishin hyrë në Korçë. Gjenerali Saraj i detyruar nga presioni i çetave shqiptare shkarkoi funksionarët grekë. Kolonelin Dekoen komandonte një detashment të përbërë nga dy kompani të fonterisë franceze, një batalion indokinez, dy skuadronë kavalerie dhe një seksion topash 65 m/m ai hyri pa rezistencë në Korçë.

Gazeta "Adriatiku" në Korçë, shkruante se njerëzit u mblodhën në shkollën e Shën Gjergjit, që në mëngjes. Aty erdhi Themistokliu me drejtuesit e Korçës. Ndërsa përpara prefekturës, ushtarët francezë, të veshur me uniformë festive, qëndronin për nder armë. Themistokliu u rrëfeu njerëzve shkaku e mblodhjes, ku deklarohet për vetëqeverisje të Shqipërisë, duke theksuar se duhet të kemi vëllazëri e dashuri mes njeri-tjetrit. Komisioni i ngritur prej katërmëdhjetë vetash, shtatë të krishterë dhe shtatë myslimanë, u nisën për në prefekturë. Komisioni që mori përsipër barrën e kujdesit për vendin u paraqit përpara kolonelit. Në komision bënin pjesë: Rafail Adhami, Kostandin Nocka, Nikolla Vangjeli, Vasil Singjeli, Vasil Kondi, Llambro Mborja, Thimi Cale, Shaqir Shabani, Tefik Rushiti, Hysen Dishnica, Emin Rakipi, Qani Dishnica, Sali Babani dhe Haki Shemshedini. Koloneli Dekoen dhe oficerët të tjerë francezë i pritën veshur me uniforma ushtarake dhe me grada. Dr. Haki Mborja



i drejtohet komandantit francez e i tregon qëllimin e ardhjes së tyre. Komandanti i priti me buzëqeshje, duke thënë, se duhet bërë protokoll. U bë protokoll.

Protokollit shqiptaro-francez

Më 10 dhjetor 1916 koloneli Dekoen firmosi me përfaqësues të Korçës protokollin shqiptaro-francez. Nënshkrimi i Protokollit të 10 dhjetorit ishte një arritje për lëvizjen patriotike dhe pati një rëndësi të madhe politike. Kjo ka të bëjë në radhë të parë me largimin e pushtuesve grekë dhe me ngritjen më pas të "krahinës autonome". Për ushtarakët francezë nuk kishte rëndësi vetëm qyteti, por dhe zona përreth. Protokollit i 10 dhjetorit për krijimin e krahinës "autonome" përfshinte të gjitha zonat ku ishin vendosur forcat franceze, Bilisht, Kolonjë, Gorë dhe Opar, të cilat do të administroheshin nga shqiptarë, nën mbrojtjen e autoriteteve franceze. Krahina do të administrohej nga një këshill administrativ, i përbërë prej katërmëdhjetë vetash, i cili do të kishte dhe xhandarmëri për të mbajtur rregullin. Gjuha zyrtare në kërkesa, ankesa e kontrata, do të ishte shqipe dhe flamuri i Krahinës "autonome", ai shqiptar, me një shirit të trengjyreshit francez. Themistokli Gërmenji doli në ballkon dhe ngriti flamurin. Ushtria franceze i rrinte për nder flamurit, kurse populli thërriste me gëzim "Rroftë Shqipëria!" Entuziazëm, një ditë e vërtetë festive! Nën tingujt e muzikës, ushtarët parakaluan me armët ngjeshur. Themistokliu me shokët, hynë brenda, uruan njëri-tjetrin dhe u nisën për në katundari. Koloneli Dekoeni i përcolli buzagaz, deri tek porta. Në katundari, komisioni i kërkoi Themistokliut, të marrë drejtimin e policisë. Ai pranoi dhe pjesëmarrësit e uruan. Sekretar i përgjith-

shëm u zgjodh, Petro Harizi.

Krahina "autonome" e Korçës, pati rëndësi të madhe dhe ishte sukses i shënuar, i forcave patriotike shqiptare. Ajo, megjithëse pati autonomi të kufizuar, arriti të sigurojë mjaft të drejta për popullin, të krijojë kushte qetësie dhe zhvillimi ekonomik, si dhe të paralizojë veprimtarinë shoviniste greke, në Shqipërinë e Jugut. Duke shfletuar gazetën "Adriatiku", njihemi me veprimtarinë e krahinës "autonome" të Korçës dhe arritjet e saj. Këshilli administrativ i krahinës, në të cilin, rolin kryesor e luante Themistokli Gërmenji, ndonëse mbante detyrën e prefektit të policisë, hartoi mjaft rregullore për administratën publike, për financat, arsimin, policinë, gjyqet, buxhetin, etj. Kujdesiu kushtua zhvillimit ekonomik të krahinës. Masa të rëndësishme u morën dhe për arsimin. Shkollat greke u mbyllën, për t'u hapur gjashtëdhjetë shkolla fillore shqipe, gjithashtu dhe një shkollë e mesme. Bashkë me francezët, u arrit të ngrihet një sistem i rregullt postar, të shtypen pulla të reja, si dhe monedha të krahinës "autonome".

Marrëdhëniet e Themistokliut dhe të funksionarëve të tjerë, të këshillit administrativ, me forcat franceze dhe sidomos, me kolonelin Dekoen, kanë qenë të mira dhe pozitive. Njëpërmjet gazetës, mësojmë se ushtarët francezë kanë dhënë një koncert, ku u mblodhën pesëqind franga. Këto franga, u ndanë për të varfrit e qytetit. Kurse, me rastin e Vitit të Ri, Themistokli Gërmenji i dhuroi kolonelit, Dekoen, një dyfek me çark dhe një kobure, të larë me ar. Edhe më simbolike, ishte dhurata e grave të shoqërisë "Ylli i mëngjesit". Ato kishin përgatitur për kolonelin, një tapita të

qëndisur me dy patkonj të bashkuar, në mes, flamuri shqiptar dhe ai francez, me fytyrën e Skënderbeut.

Republika "autonome" e Korçës që kur u krijua, u prit në mënyrë armiqësore dhe të ashpër nga shovinistët grekë dhe qeveria italiane. Veprimi i gjeneral Sarrait, komandant i Armatës së Lindjes, kishte rënë si bombë në kancelaritë e Fuqive të Mëdha, ndaj ato bënin presion për shfuqizimin e protokollit të datës, 10 dhjetor. Si rezultat i këtyre presioneve, qëndrimi i forcave franceze ndaj lëvizjes patriotike shqiptare, në Korçë dhe krahinës "autonome", filloi të ndryshojë. Ata po ndiqnin, tashmë dhe arrestonin, patriotët shqiptarë. Në këto kushte, gjenerali Sarrai, u detyrua të largonte nga Korça, kolonelin Dekoen, në maj, të vitit 1917, megjithëse e ngrinte lart veprimtarinë e

të mahnitur. Ai ishte i veshur me rroba kombëtare dhe ecte me hapin e qetë dhe plot dinjitet. Fjalët e tij të fundit, që iu drejtuan përfaqësuesit ushtarak francez, ishin. "Ju, nuk e njihni mentalitetin shqiptar. Nuk e njihni shpirtin e popullit tim! Ju, po bëni një gabim shumë të madh. Rroftë Shqipëria!". Vrasja e Themistokli Gërmenjit, ishte një humbje e madhe për krahinën "autonome" të Korçës dhe lëvizjen kombëtare shqiptare.

Pas pushkatimit të Themistokliut, organet e sigurimit francez i vazhduan persekutimet e tyre. Ato arrestuan një pjesë të bashkëpunëtorëve të Themistokliut si Qamil Panaritit drejtor i Policisë, Mehmet Pupen, komisar i policisë, si edhe Mehmet, Sejfullah e Maliq bej Pojanin, të cilët u dënuan me vdekje. Mbasi dënimi i tyre u zbrit në 20 vjet



tij. Pas largimit të tij nga Korça, ngjarjet u zhvilluan me shpejtësi. Në muajin nëntor të këtij viti, elementë grekomanë dhe bejlerë të Korçës, montuan fsheturazi, një proces kundër Themistokli Gërmenjit, duke e akuzuar atë, për tradhti dhe agjent të austriakëve. Me shpejtësi të madhe, një gjyq ushtarak i "Armatës së Lindjes", në Selanik, e dënoi atë me vdekje më 7 nëntor dhe e ekzekutoi, më 9 nëntor 1917.

Qëndrim burrëror dhe dinjitoz

Qëndrimi i Themistokliut, përpara gjyqit dhe përpara ekzekutimit, ishte burrëror dhe dinjitoz. Në letrën që i shkruante së shoqes, ai theksonte se "Jam viktimë e mashtrimeve", "Vdes i pafajshëm" dhe "Rroftë Shqipëria!". Ndërsa një oficer francez, i cili e pa me sy vrasjen, e përshkruan kështu ngjarjen. "E kam njohur Themistokli Gërmenjin dhe u ndodha i pranishëm kur u pushkatua. Ai nuk tregoi asnjë shenjë frike, përpara vdekjes. Të gjithë sa ishim aty, mbetëm

të burgosurit u dërguan në Guaiane, një koloni franceze në Amerikën e Jugut. Bashkë me këta u dërguan dhe 30 veta të tjerë. Me dënimin e tyre, Republika e Korçës mori fund... Autoritetet ushtarake franceze, nuk guxuan të zhduknin të gjitha fitoret e arritura nga përpjekjet dhe lufta e patriotëve shqiptarë. Në krahinë vazhdoi të ngrihej flamuri shqiptar, krahas atij francez dhe shkollat që u hapën, e vazhduan mësimdhënien.

Me mbarimin e Luftës së Parë Botërore, në maj, të vitit 1920, forcat franceze u larguan nga Korça, duke marrë fund kështu edhe krahina "autonome" e Korçës. Populli i kujton ata, si aleat në ato çaste të vështira dhe krahinën "autonome", si një sukses të asaj periudhe, që ndikoi drejtpërdrejt, në ruajtjen e tërësisë tokësore të atdheut. Ata u larguan, duke lënë pas kujtimin e mirë dhe varret e ushtarëve francezë, sikurse edhe liceun francez, që edukoi për dekada të tëra, brezat e rinj.



103

vite nga përfundimi
i Luftës së Parë
Botërore

“Lufta për t’i dhënë fund të gjitha luftërave”

Në Belgjikë, “Last Post” do të tingëllojë nën memorialin Menin Gate në Ypres, së bashku me një paradë tradicionale me lulëkuqe. “Last Post” është përshëndetja tradicionale e fundit për të rënë, e cila luhet për nder të kujtimit të ushtarëve të ish-Perandorisë Britanike dhe aleatëve të saj, të cilët vdiqën në Ypres Salient gjatë Luftës së Parë Botërore, 1914-1918. Emrat e rreth 55,000 ushtarëve, eshtrat e të cilëve nuk u gjetën kurrë, janë gdhendur nën Portën e Meninit.

Në Francë, Presidenti Emmanuel Macron do të shoqërohet nga Zv. Presidentja e SHBA-së, Kamala Harris, në një ceremoni për nder të një prej heronjve të rezistencës të Francës në Luftën e Dytë Botërore.

Hubert Germain, i cili ishte i dekoruari i fundit i mbijetuar i Urdhrit të Çlirimit (Compagnon de la Libération), do të varroset në Mont-Valérien në Paris, vendi kryesor i ekzekutimit të luftëtarëve të rezistencës gjatë asaj luftime.

11 Nëntori i vitit 1918, shënon datën kur morën fund luftimet në Luftën e Parë Botërore, pasi Aleatët dhe Gjermania nënshkruan një marrëveshje armëpushimi.

Lufta e Parë Botërore u quajt “lufta për t’i dhënë fund të gjitha luftërave” pas ndërprerjes së saj dhe kushtoi rreth 8.5 milionë jetë ushtarësh si dhe 13 milionë jetë civilë si rezultat i drejtpërdrejtë i luftimeve.



Bashkëpunimi me akademinë ushtarake të West Point në SHBA për të adoptuar modelet, standardet dhe arritjet edhe në Akademinë e FA-së

Një kampus i ri nga fillimi,

në një sipërfaqe të dedikuar për të do të fillojë ndërtimin nga viti që vjen

